

2019

# RAPORTI VJETOR

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT




AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT



**2019**

# **RAPORTI VJETOR**

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHËTETIT**



**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHËTETIT**



## PËRMBAJTJA

Hyrje .....	7
01 Mesazhi .....	8
02 Kuadri ligjor .....	11
03 Respektimi dhe plotësimi i detyrimeve ndërkombëtare, Përbushja e rekomandimeve të “Progres Raportit” të BE-së për Shqipërinë.....	14
04 Zbatimi i rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së aidssh-së për vitin 2019.....	18
05 Veprimtaria e AIDSSH-së për vitin 2019 .....	26
6.1 Aktiviteti i institucionit.....	27
6.1.1 Arkivi .....	27
6.1.2 Informacioni .....	31
6.1.3 Hulumtimi Shkencor dhe Edukimi Qytetar .....	35
6.1.4 Siguria dhe Zhvillimi Teknologjik.....	48
6.1.5 Të dhëna dhe shifra mbi aktivitetin e AIDSSH-së të krahasuara me vitin 2017, 2018, 2019.....	51
5.2 Objektivat e institucionit për vitin 2020.....	54
5.3 Synimet për të ardhmen.....	55
5.4 Parashikimi trevjeçar në lidhje me vizionin e institucionit .....	55
06 detyrimeT ligjore nga AIDSSH dhe përgjegjësitë në rastet kur ligji është shkelur apo nuk është konsideruar .....	57
07 Statusi në zbatim të rekomandimeve që institucione të tjera kushtetuese ose të pavarura kanë dhënë për AIDSSH-në .	59
08 Ndryshimet në kuadrin rregullator për vitin 2019 dhe efektet e tyre .....	61
09 Mbi problematikat e ndeshura në veprimtarinë e AIDSSH-së me qëllim gjetjen e rrugëve më efikase për zgjidhjen e tyre nga Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave .....	64
10 Nevoja për ndryshime në kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e AIDSSH-së.....	67
11 Organizimi i brendshëm i institucionit.....	70
12 Kallëzimet penale dhe proceset gjyqësore.....	79



# HYRJE

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit u krijua me Ligjin nr. 45/2015 *“Për të drejtën e informimit mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*, për të bërë të mundur ushtrimin e së drejtës nga çdo i interesuar për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet një procesi demokratik dhe transparent, mbrojtjes së personalitetit të individit, si dhe unitetit e pajtimit kombëtar.

AIDSSH është institucion i pavarur, përgjegjës për mbledhjen, administrimin, përpunimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe për sigurimin e aksesit në ta, për të gjitha subjektet e ligjit nr. 45/2015, në funksion të edukimit të publikut dhe mbështetjes së vlerave demokratike të drejtësisë, së vërtetës, pajtimit dhe përgjegjësisë për gjeneratat e ardhshme.

AIDSSH e ka mbështetur veprimtarinë e vet dhe vijimësinë e projekteve të ndërmarra në funksion të veprimtarisë hulumtuese dhe kërkimit shkencor, duke synuar rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit apo edukimit qytetar.

Raporti vjetor i punës 2019 është hartuar dhe miratuar duke u mbështetur në ligjin nr. 45/2015 dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të ligjit të sipërcituar, që

normojnë dhe rregullojnë veprimtarinë funksionale të institucionit. Sipas këtij raporti, veprimtaria e institucionit për vitin 2019 është e fokusuar në disa shtylla kryesore: konsolidimi i arkivit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, sigurimi i aksesit në dokumentet e ish-Sigurimit për të gjitha subjektet e përcaktuara në ligj, rishqyrtimi historik i veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit, duke u mbështetur në kërkimin shkencor, të realizuar në bashkëpunim me institucionet kërkimore-shkencore në vend dhe institucione partnere, si dhe ndërtimi i një platforme komunikimi dhe dialogimi mbarëkombëtar, në funksion të edukimit qytetar, duke organizuar tryeza pune me grupe të ndryshme interesi, seminare, ekspozita dokumentare, konferenca shkencore ndërkombëtare, etj.

Në përputhje me rezolutën e Parlamentit Europian 2019, mbi rëndësinë e një kujtese të përbashkët europiane, ku shprehet respekti për çdo viktimë të sistemeve totalitare dhe mbështetje për përkujtimin e tyre, AIDSSH e ka organizuar veprimtarinë e vet të zbardhjes së të shkuarës në hapjen e dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit për të interesuarit, familjarë, studiues e gazetarë; informimin me përgjegjësi për pastërtinë e funksionarëve të lartë; rivlerësimin (ridimensionimin) e viktimave dhe të dënuarve të ndërgjegjes dhe trajtimin e çështjes së të zhdukurve në diktaturë.

The background of the image is a light purple or lavender color with a pattern of faint, handwritten text in a cursive script. The text is mostly illegible due to blurring and low contrast, but some words like 'bēn', 'mafi', 'obete', and 'keim bēi' are partially visible.

# 01 MESAZHI



Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit u krijua në frymën e rezolutave europiane dhe shqiptare për domosdoshmërinë e dënimit të krimeve të komunizmit, në mbrojtje të vlerave demokratike dhe të drejtave e lirive themelore të njeriut.

AIDSSH mbylli vitin e tretë të funksionimit mes sfidash e arritjesh në veprimtarinë e përditshme: 70 mbledhje dhe 843 vendime, nga të cilat 832 vendime unanime, 9 marrëveshje bashkëpunimi, 286 kandidatë apo zyrtarë të verifikuar, 506 aplikime individuale, 135 kërkesa institucionale, 29 kërkesa për zbardhjen e bashkëpunëtorëve, 5 kërkesa për qëllime rehabilitimi dhe dëmshpërblimi, 158 kërkesa për pajisjen me vërtetim për periudhën e internimit apo burgimit, 105 kërkesa studimore e mediatike me 1500 dosje të trajtuara, 92 777 dokumente të deklasifikuar, 170 150 faqe të vëna në dispozicion në 2019.

Gjatë vitit 2019 ka pasur rritje të numrit të kërkesave për informim për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, kryesisht të paraqitura nga institucionet kushtetuese apo autoritetet publike, studiuesit dhe përfaqësuesit e medias, në mënyrë të veçantë kërkesat e paraqitura nga subjektet e interesuara për pajisjen me vërtetim për periudhën e internimit apo burgimit. Paralelisht me prioritetet, institucioni ka zhvilluar funksionet e veta, në përgjigje të kërkesave të qytetarëve, institucioneve, grupeve të interesit, kërkesave shkencorë dhe mediave kombëtare e të huaja.

Me një strategji gjithëpërfshirëse komunikimi, të fokusuar te njeriu, familjarët e viktimave, shoqatat e të drejtave të njeriut, të rinjtë e publiku i gjerë, AIDSSH e ka zgjeruar ndjeshëm hartën e veprimtarisë, në bashkëpunim me komunitetet lokale

në Tiranë, Gjirokastrë, Tepelenë, Konispol, Korçë, Voskopojë, Maliq, Belsh, Lushnjë, Përmet e më gjerë, duke arritur tek individët, bashkësitë dhe institucionet homologe të kujtesës.

Konsolidimi në një arkiv të vetëm i gjitha dokumenteve të ish-Sigurimi i Shtetit, me rëndësi për trashëgiminë historike kombëtare vijon të mbetet sfidë e AIDSSH. Procesi i marrjes në dorëzim të dokumenteve në përputhje me VKM-së 98/2017 është frenuar në mes të vitit 2019 nga Ministria e Punëve të Brendshme, frenim që ka ndikuar në përmbushjen e detyrimit ligjor për marrjen në dorëzim të të gjithë dokumentacionit të administruar nga institucionet përkatëse, sipas ligjit 45/2015.

Edhe përgjatë vitit 2019, AIDSSH ka ushtruar funksionet në ndërtesën e përkohshme pranë Gardës së Republikës, dhe arkivi ka vijuar të jetë i lokalizuar në dy godina të ndryshme. Kjo situatë ka paraqitur vështirësi, sa i takon shërbimit të qytetarëve, kushteve të përshtatshme të punës dhe studimit, shërbimit të dokumenteve arkivore dhe vënies në dispozicion në kohë të shkurtër.

Tërmeti i 26 nëntorit ndikoi në proceset e punës, duke paralizuar lëvizjen në fondin e dokumenteve pranë IPQP, ndërtesë e dëmtuar ndjeshëm dhe duke krijuar pamundësi për shërbim të dokumenteve qytetarëve e studiuesve. Po ashtu, salla kryesore e AIDSSH, e vendosur në mjediset e Gardës, u vlerësua e rrezikshme dhe për pasojë, e papërdorshme për funksionet e institucionit: mbledhje Autoriteti, takime me grupet e interesit, seminare, ekspozita dokumentare, etj.

Qeveria Shqiptare nuk akordoi buxhet për rikonstruksionin e godinës së AIDSSH në 2019. Institucioni arriti të përfntonte një grant nga Qeveria Suedeze për krijimin e kushteve dhe standardeve bashkëkohore të punës, përfshirë shërbimet e integruara TIK. Përgjatë 2019 u firmosën marrëveshjet përkatëse dhe u hodhën hapat për lëvrimin e fondit dhe fillimin e zbatimit të projektit në 2020-2021.

Mes sfidave të ardhshme mbetet plotësimi i strukturës së miratuar nga Kuvendi. Autoriteti i ka kryer funksionet e veta me 50 % të stafit, fakt që e ka përballur me radhë të gjata, ka rritur kohën e pritjes për marrje shërbimesh dhe ka ndikuar proceset e përditshme të punës.

Me sigurimin e infrastrukturës së përshtatshme dhe organikën e miratuar, për përmbushjen e rolit të vet në zbardhjen e së shkuarës, Autoriteti propozon nevojën për ndërhyrje në ligje të lidhura me veprimtarinë e tij, kryesisht si ligji 45/2015, ligji për reformën zgjedhore, VKM nr.188, për miratimin e rregullores për sigurinë e personelit, propozime ligjore këto që i paraqiten Kuvendit dhe Qeverisë shqiptare për të fuqizuar rolin e institucionit në aspektin e transparencës për figurat zyrtare gjatë procesit të emërimit apo zgjedhjes së tyre, dhe krijimin e një arkivi të integruar.

Fuqizimi i AIDSSH si institucion i ngarkuar për kryerjen e veprimtarisë hulumtuese dhe kërkimit shkencor, me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit dhe edukimit qytetar, duke i trajtuar me përgjegjësi materialet arkivore të administruara, informimin e individëve, familjeve, studuesve e mediave, rivlerësimin e personaliteteve dhe ngjarjeve historike, ndjekjen e çështjes së të zhdururve, publikimin dhe shpërndarjen në platforma zyrtare e sociale të artikujve shkencorë e botimeve cilësore mbi të shkuarën, në ndihmë të shoqërisë e brezave të rinj, mund të arrihet me

ridimensionimin e tij si institucion i kujtesës, pas ndryshimeve ligjore përkatëse, sipas modelit të institucioneve homologe.

Në 30-vjetorin e fillimit të ndryshimeve demokratike në vend që çuan në rënien e komunizmit dhe në 100 vjetorin e Tiranës kryeqytet, AIDSSH e zhvillon veprimtarinë e vet me vetëdije për historinë dhe përgjegjësi për të ardhmen, sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në respekt të vlerave europiane e properëndimore, ku njohja dhe rritja e vetëdijes për trashëgiminë e përbashkët evropiane të krimeve të kryera nga diktaturat komuniste, naziste e të tjera, kanë rëndësi jetike për unitetin e Europës.

AIDSSH po punon për organizimin e veprimtarive të rëndësishme, sipas kalendarit të kujtesës, të mbështetura nga bashkëpunëtorë, institucione të memories dhe homologë, duke i propozuar Qeverisë Shqiptare VKM-në përkatëse për projektin dyvjeçar #Demokraci 30, projekt që do të kalojë në fazat e zhvillimit të tij pas miratimit në Autoritet, tek institucionet e tjera qendrore dhe vendore të përfshira në të. Bashkëpunimi ndërinstitutional në zbardhjen e së shkuarës do të ketë të bëjë me trajtimin e ngjarjeve e personaliteteve historike, propozimet për të nderuar shembujt e qëndresës, shenjimin e vendeve të kujtesës, takimet me të mbijetuar, mbledhjen e dëshmimeve, kontributin dhe organizimin e grupeve studimore, deklasifikimin e dokumenteve dhe vënien në dispozicion, dokumentarët, ekspozitat arkivore dhe të profileve njerëzore, për rikthimin e dinjitetit individëve dhe nxitje të dialogut shoqëror.

Pas tre viteve veprimtari komplekse, Autoriteti e gjen veten me përgjegjësi të shtuar dhe pritshmëri të rritura për informimin e shoqërisë dhe hapjen e dialogut qytetar për demokraci.

# 02

## KUADRI LIGJOR

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si organ i lartë shtetëror, i pavarur, i ngarkuar për administrimin e procesit të informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për realizimin e misionit të vet udhëhiqet nga parimet e pajtimit dhe unitetit kombëtar, transparencës dhe bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore.

AIDSSH organizohet dhe funksionon sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" dhe në rregulloren "Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit", miratuar me Vendimin e Autoritetit nr. 21, datë 09.05.2017. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, Autoriteti ndihmohet nga Sekretariati Teknik, i cili vepron në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin organik dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij. Rregulla të hollësishme për funksionimin dhe veprimtarinë e Sekretariatit Teknik janë përcaktuar në rregulloren e brendshme të Autoritetit. Në organizimin dhe ushtrimin e funksioneve të veta, AIDSSH bazohet në aktet e mëposhtme ligjore dhe nënligjore:

#### **Akte ligjore dhe nënligjore**

- Ligji nr. 45, datë 30.04.2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
- Ligji nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike";
- Ligji nr. 8457, datë 11.02.1999, "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", i ndryshuar;

- Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat" dhe Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë;
- Ligji Nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë";
- Ligji Nr. 12/2018, "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Shërbimet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme";
- Ligji Nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë" si dhe Vendimi Nr.816/2015, "Për miratimin e rregullores për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë";
- Ligji Nr.7514, datë 30.9.1991 "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtje e të dhënave personale", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit";
- Ligji Nr. 152, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 98, datë 15.02.2017, "Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivore që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritete të tjera publike";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 935, datë 28.12.2016, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi,

nga Ministria e Mbrojtjes tek Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të objektit nr. 52, me emërtim “Arkivi i Ri”, brenda Territorit të Pronës nr. 12, me emërtimin “Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes”, me vendndodhje lagjja nr. 10, Rruga e Dibrës, Tiranë dhe për një ndryshim në Vendimin nr. 515, datë 18.07.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, i ndryshuar, me anë të së cilës është përcaktuar mjedisi në të cilin AIDSSH do të ushtrojë veprimtarinë e vet;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave dhe pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”;

#### **Akte rregullatore të brendshme të AIDSSH**

- Rregullore e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e AIDSSH”, miratuar me Vendimin Nr. 21, datë 09.05.2017 të Autoritetit, e ndryshuar me Vendimin nr.234, datë 24.04.2019;
- Rregullore “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike në AIDSSH”, miratuar me Vendimin Nr. 13, datë 14.04.2017;

- Rregullore “Për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale në AIDSSH”, miratuar me Vendimin Nr. 25, datë 25/05/2017, të Autoritetit;
- Rregullore “Mbi publikimin e veprimtarisë së Autoritetit, në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj, përmes buletinit në letër apo online në faqen e Autoritetit”;
- Vendimi i Kuvendit nr. 95, datë 22.12.2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”;
- Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit të AIDSSH 2017-2020, miratuar me Vendimin Nr. 42, datë 22.06.2017 të Autoritetit;
- “Kodi i sjelljes së mirë administrative në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me Vendimin Nr. 449, dt. 18.12.2018, të Autoritetit;
- “Kodi i sjelljes” për Anëtarët e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me Vendimin Nr. 450, dt 18.12.2018.

# 03

RESPEKTIMI DHE PLOTËSIMI I  
DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE,  
PËRMBUSHJA E  
REKOMANDIMEVE TË “PROGRES  
RAPORTIT” TË BE-SË PËR  
SHQIPËRINË

## Detyrimet ndërkombëtare

Hapja dhe trajtimi i dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit për zbardhjen e të shkuarës, në funksion të transparencës dhe konsolidimit të demokracisë, çoi në krijimin e AIDSSH në vitin 2016, pas miratimit të ligjit nr.45/2015. Në frymën e rezolutave ndërkombëtare që kanë trajtuar trashëgiminë e së shkuarës, si Rezoluta e Parlamentit Europian “Mbi ndërgjegjen europiane dhe totalitarizmin” (2009), Deklarata e Pragës “Mbi ndërgjegjen europiane dhe komunizmin” (2008), Rezoluta 1096 (1996) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës “Masat për të çrrënjësuar trashëgiminë e sistemeve totalitare komuniste”, si dhe Rezoluta 1481 (2006) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës “Domosdoshmëria për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste”, të njohura nga Kuvendi i Shqipërisë, në vijim të të cilave janë miratuar Rezoluta nr.11 “Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri” (2006) dhe Rezoluta “Për dënimin e krimeve të komunizmit ndaj klerit, si dhe mirënjohjen e veçantë për rolin dhe veprimtarinë e klerikëve në mbrojtje të vlerave demokratike dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut” (2016), AIDSSH ushtron prej tre vitesh veprimtarinë e vet.

Në shtator 2019, Parlamenti Europian miratoi rezolutën mbi rëndësinë e një kujtese të përbashkët europiane, duke shprehur respekt për secilën viktimë të sistemeve totalitare, mbështetje për përkujtimin dhe shqetësim për përdorimin e simboleve të regjimeve dhe glorifikimin e tyre. Duke pasur parasysh që kujtimet e së kaluarës tragjike të Europës duhet të mbahen gjallë, në mënyrë që të nderohen viktimat, të dënohen autorët dhe të shtrohet rruga për pajtim, bazuar tek e vërteta dhe

përkujtimi, rezoluta e PE thotë se kujtimi i viktimave të regjimeve totalitare, sikundër njohja dhe rritja e vetëdijes për trashëgiminë e përbashkët evropiane të krimeve të kryera nga diktaturat komuniste, naziste dhe të tjera, kanë rëndësi jetike për unitetin e Evropës.

Shqipëria është angazhuar për forcimin e sistemit të drejtësisë dhe të drejtave të njeriut, nëpërmjet ratifikimit të traktateve ndërkombëtare e rajonale dhe përfshirjes së saj në Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara 2030. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Qytetare dhe Civile dhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut njohin barazinë përpara ligjit dhe elementë të tjerë kyç që forcojnë sistemin e drejtësisë.

## Kombet e Bashkuara

Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, me objektivin 16 të zhvillimit të qëndrueshëm synon shoqëri gjithëpërfshirëse dhe që jetojnë në paqe, akses në drejtësi dhe institucione efektive e të besueshme, si elementë thelbësorë për zhvillimin. Më tej, Kombet e Bashkuara për Shqipërinë pohojnë se forcimi i ligjit, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve në institucionet e drejtësisë dhe përmirësimit të proceseve të drejtësisë tranzicionale, ndihmon sigurimin e së vërtetës, e ridimensionon atë dhe u jep zë viktimave, elemente që vënë themelet për zhvillim të qëndrueshëm dhe paqe në shoqëri. Në këtë kuadër, edhe gjatë vitit 2019, AIDSSH ka kontribuar në përmbushjen e rekomandimeve të Grupit të Punës të OKB-së për Personat e Zhdukur (WGEID).

## Bashkimi European

Në Raportin e Progresit 2019 të Komisionit European për Shqipërinë vihet theksi në monitorimin e proceseve të zbatimit të reformës në drejtësi, në veçanti vlerësimi i figurës së gjyqtarëve dhe prokurorëve (vettingu).

Sipas raportit, rivlerësimi i funksionarëve të lartë të drejtësisë ka prodhuar rezultate konkrete dhe të besueshme, të cilat e kanë forcuar sektorin dhe kanë konsoliduar pavarësinë, paanshmërinë, profesionalizmin dhe llogaridhënien e institucioneve të gjyqësorit. Zbatimi i reformës në drejtësi është konsoliduar duke njohur progres.

Në këtë kuadër, AIDSSH ka detyrimin ligjor të verifikimit të pastërtisë së figurave të zyrtarëve të lartë, të cilët i janë nënshtruar procesit edhe gjatë vitit 2019, proces që përfshin shumë institucione dhe synon rritjen e profesionalizmit në të gjitha sferat, konsolidimin e pavarësisë e paansisë dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet.

Po në raportin e KE për 2019, Shqipërisë i është kërkuar të ndërmarrë masa efektive për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ku vendi ynë ka ratifikuar konventat ndërkombëtare përkatëse.

Në kapitullin Sistemi i Drejtësisë dhe të Drejtat Themelore të Njeriut, në dokumentin e Komisionit European të datës 29.05.2019, "Progress Report 2019 Albania", faqe 24, përmenden rekomandime për Shqipërinë që kanë të bëjnë me krimet e kryera gjatë komunizmit, pas vizitës në vend të Grupit të Punës të OKB-së për personat e zhdukur në mënyrë të detyruar apo vullnetare (WGEID).

Në rubrikën "E drejta për jetën", në vijim të rekomandimeve të Grupit të OKB-së, u arrit të firmoset një marrëveshje bashkëpunimi në korrik 2018 mes Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) dhe Qeverisë së Shqipërisë, e ratifikuar në nëntor 2018 nga Kuvendi, duke e lejuar ICMP të fillojë mbledhjen e mostrave të ADN-së, me mbështetje financiare të BE.

Nëpërmjet Ministrisë së Europës dhe Punëve të Jashtme, Grupi i Punës i OKB-së i kërkoi AIDSSH-së pëmbushjen e rekomandimeve për Shqipërinë për vitin 2019, për trajtimin e krimeve të kryera gjatë diktaturës komuniste.

### Zbatimi i rekomandimeve nga AIDSSH

Bazuar në rekomandimet dhe detyrat funksionale që i ngarkon ligji 45/2015, AIDSSH është angazhuar aktivisht dhe ka bashkëpunuar me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) e institucione të tjera publike në vend për personat e humbur, Institutin e Integritit të të Përndjekurve Politikë dhe vijon të japë kontribut konkret në sigurimin e informacionit dokumentar të lidhur me ta; po ashtu, në ngritjen e çështjes dhe lobimin me institucione publike e ndërkombëtare për avancim të kërkimeve.

AIDSSH ka marrë pjesë dhe ka qenë aktive në hartim aktesh, në diskutime dhe tryeza të rrumbullakëta e ngjarje përkujtimore dhe nëpërmjet vënies në dispozicion të dokumenteve arkivore të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit që lidhen me vendkzekutimet dhe me vendvarrimet masive të regjimit komunist. Po ashtu, institucioni është pjesë e "Grupit ndërinstitucional të punës për hartimin dhe zbatimin e masave për kërkimin,



identifikimin e kthimin në atdhe të eshtrave të shtetasit italian Giuseppe Terrusi”.

Në 2019, AIDSSH ka përshkallëzuar veprimet konkrete sa i takon bashkëpunimit mes institucioneve qendrore dhe lokale për të zhdukurit në diktaturë. (informacioni i plotë në kapitullin 4 për Zbatimin e Rezolutës së Kuvendit për vitin 2019, seksioni për të zhdukurit dhe bashkëpunimin institucional).

Raporti mbi veprimtarinë për të zhdukurit i është dorëzuar MEPJ, që koordinon përmbushjen institucionale të rekomandimeve për Grupin e Zhdukjeve me Forcë në Kombet e Bashkuara.

# 04

ZBATIMI I REZOLUTËS SË  
KUVENDIT PËR VLERËSIMIN E  
VEPRIMTARISË SË AIDSSH-SË  
PËR VITIN 2019

Në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 134/2018, “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar më datë 08.05.2019, në vijim të vlerësimit të veprimtarisë së ushtruar nga AIDSSH gjatë vitit 2019, ka renditur disa detyra dhe rekomandime që duhej të përmbusheshin gjatë 2019, konkretisht:

**Përmirësimi i procesit të verifikimit të të dhënave, me qëllim nxjerrjen e vendimeve që përmbajnë të dhëna të sakta dhe precize, të cilat të mos jetë e nevojshme të korrigjohen.**

Në përmbushje të kësaj detyre, gjatë vitit 2019, nga drejtoritë dhe sektorët është punuar si më poshtë:

1. Autoriteti, me vendim të veçantë ka vendosur të ndryshojë formularin e miratuar që përdoret në kuadër të vlerësimit, sipas legjislacionit përkatës, të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t’u emëruar ose ngritur në detyrë, për zyrtarët, institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike. Kjo e ndihmon Autoritetin që të zbatojë më mirë përcaktimet e nenit 29, pika 4 të ligjit 45/2015.
2. Ka përfunduar puna për krijimin e një baze të dhënash elektronike, në të cilën janë regjistruar të gjitha dokumentet e fondeve “Komisioni Mezini” dhe “Komisioni Bezhani”.
3. Kërkesat e paraqitura nga institucionet kushtetuese apo autoritetet publike janë trajtuar me përparësi. Në

rastet kur nuk përputheshin gjeneralitetet janë përdorur informacione, bazuar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile për ballafaqimin e të dhënave, për të eliminuar apo minimizuar pasaktësitë në dhënien e informacionit zyrtar.

4. Është përmirësuar mënyra e kërkimit në arkiv, duke krijuar mjete të reja kërkimi dhe përmirësuar procedurën e kërkimit me elementë të tjerë, të cilët ndihmojnë në identifikimin e të dhënave të kërkuara.

**Përfundimi brenda vitit 2019, i procesit të marrjes në dorëzim dhe inventarizimit të të gjitha dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit**

Në mbështetje të ligjit 45/2015 dhe VKM 98/2017 ka vijuar komunikimi me institucionet të cilat kanë detyrimin të identifikojnë dhe dorëzojnë dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit pranë AIDSSH-së. Procesi ka qenë i fokusuar më së shumti në marrjen në dorëzimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit nga Arkivi i Sistemit të Ministrisë së Brendshme (ASMB), institucion ky në varësi të Ministrisë së Brendshme. Procesi ka ecur me ritme shumë të ngadalta dhe nuk është përfunduar. Procesi i marrjes në dorëzim të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit nga ASMB është pothuajse i bllokuar që nga muaji maj 2019. Për zgjidhjen e kësaj shtate, në mbështetje të ligjit 45/2015 dhe VKM 98/2017 ka pasur komunikim të vazhdueshëm shkresor dhe takime me zyrtarë të lartë të Ministrisë së Brendshme. Situata mbetet e njëjtë.

Përgatitja e infrastrukturës logjistike të nevojshme për përfundimin, brenda vitit 2019, të procesit të transferimit nga arkivat e institucioneve të ndryshme, të të gjithë dokumentacionit që është marrë në dorëzim nga Autoriteti, si dhe angazhimi maksimal i të gjitha palëve të përfshira në proces, për ndërmarrjen e hapave për parandalimin e dëmtimit të mëtejshëm dhe ruajtjen e materialit arkivor ekzistues.

Në mungesë të mjeteve financiare nga buxheti i shtetit për vitin 2019, AIDSSH ka bërë përpjekje maksimale për gjetjen e mjeteve të financimit nga donatorë potencialë. Kështu që:

1. Në gusht 2019 është nënshkruar marrëveshja ndërmjet dy palëve SIDA (Ambasada Suedeze) – AIDSSH, dhe janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore dhe financiare për implementimin e fondeve sipas projektit të rikonstruksionit të ndërtesës, të dakordësuar me donatorin. Ka nisur puna në lidhje me objektin e prokurimeve “Blerje dhe montim raftesh”.
2. Është komunikuar me Ministrinë e Mbrojtjes, për sa i takon sigurisë dhe ruajtjes fizike të objektit të godinës së re të AIDSSH-së. Ministria e Mbrojtjes ka marrë përsipër sigurinë dhe ruajtjen fizike të objektit që ndodhet brenda territorit të saj.

Aktualisht, AIDSSH vijon procedurat e prokurimit për realizimin e punimeve ndërtimore të rikonstruksionit të godinës.

3. Janë kryer procedurat rutinë të arkivit për sa i takon parandalimit të dëmtimit dhe ruajtjes së materialit arkivor ekzistues. Konkretisht është kryer dezinfektimi dhe deratizimi i mjedisëve të arkivit.

Rritja e bashkëpunimit me institucionet qeveritare, për përfundimin sa më parë të procesit të identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, si dhe marrja e masave të menjëhershme për të ruajtur dhe mbrojtur në mënyrë adekuate vendet që aktualisht janë identifikuar si varreza masive.

Në kuadër të ballafaqimit me të kaluarën komuniste në Shqipëri, përfshirë punën me ish-të burgosurit politikë dhe viktimat, familjet e tyre, të afërmit e personave të zhdukur, në mbështetje të edukimit qytetar, - për të rritur ndërgjegjësimin e publikut mbi drejtësinë tranzicionale dhe pajtuese, - si dhe organizimit të aktiviteteve përkujtimore, është zgjeruar fusha e bashkëpunimit me organizata vendase dhe të huaja, si Komisioni Ndërkombëtar i Personave të Zhdukur (International Commission on Missing Persons) ICMP.

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është të ndihmojë autoritetet të zbatojnë proceset e krijuara për të gjetur dhe identifikuar personat e zhdukur dhe për të përfshirë standardet dhe normat e shoqërisë pluraliste, demokratike në këto procese.

Dy institucionet janë përfshirë në diskutime dhe tryeza të rumbullakëta dhe ngjarje përkujtimore. ICMP dhe AIDSSH kanë rënë dakord bashkërisht për strategjinë, rezultatet e përgjithshme, objektivat dhe aktivitetet dhe rolin e secilit institucion në këtë marrëveshje.

Në këtë kuadër AIDSSH ka marrë pjesë dhe ka qenë aktive në hartim aktesh, në diskutime dhe tryeza të rumbullakëta e ngjarje përkujtimore, ka ndihmuar në procesin e identifikimit nëpërmjet vënies në dispozicion, mbi bazë kërkesë dhe konform ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të

Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” të dokumenteve arkivore të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit që lidhen me vendekzekutimet dhe me vendvarrimet masive gjatë regjimit komunist.

AIDSSH është pjesë e “Grupit ndërinstitucional të punës për hartimin dhe zbatimin e masave për kërkimin, identifikimin e kthimin në atdhe të eshtrave të shtetasit italian Giuseppe Terrusi”.

AIDSSH ka përshkallëzuar veprimet konkrete sa i takon bashkëpunimit mes institucioneve qendrore dhe lokale për të zhdukurit në diktaturë.

Të gjitha njësitë të qeverisjes vendore, Kuvendit dhe Ministrisë së Drejtësisë, u është kërkuar me shkresat përkatëse drejtuar secilës bashki në vend, që të merren masa për ruajtjen dhe mbrojtjen e vendeve të pushkatimit dhe vendvarrimeve të fshehta apo të deklaruara të periudhës së diktaturës, duke siguruar parandalimin e trajtimit të paligjshëm të vendeve të pushkatimit dhe vendvarrimeve; mostjetërsimin e sipërfaqeve të këtyre vendeve; frenimin e shkatërrimit të objekteve dhe vendeve ku janë evidentuar veprimtari të shtetit komunist ndaj individëve, duke i vendosur këto vende në ruajtje dhe mbrojtje të posaçme, mbështetur edhe në vëzhgimet e pasqyruara nga Grupi i Punës së Personave të Zhdukur me Forcë në Rezolutën e 2017 të Kombeve të Bashkuara, ku evidentohet si detyrë “shenjimi i vendeve ku mendohet të gjenden eshtra gjatë periudhës së diktaturës”, dhe kërkohet të ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm për gjetjen e personave të zhdukur.

Bashkëlidhur kërkesës, AIDSSH ka dorëzuar pranë bashkive hartën paraprake me vendvarrime të raportuara, (burimi IIPP dhe ICMP) dhe rezultatet e

grumbulluara deri tani në nivel kombëtar nga aplikacionet e ICMP, Qendra e Kërkimit Online dhe Gjurmuesi i Vendvarrimeve, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit të 2018 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur.

AIDSSH i ka kërkuar çdo bashkie dhe këshilli bashkiak të kryejë shenjimin e vendvarrimeve të mundshme të të pagjeturve në territorin e saj administrativ dhe njëherazi, të vendosë në mbrojtje (mbikëqyrje të posaçme) vendet e internimit, kampet e punës dhe burgjet, të raportuara më herët nga qytetarët.

Deri tani, pranë AIDSSH janë paraqitur 75 kërkesa me objekt rehabilitimin dhe qartësimin e fatit të vdekurve apo të zhdukurve. Të gjitha raportimet i janë kaluar IIPP, që koordinon me AIDSSH e ICMP për informacionin e njëzuar për rreth 6000 të zhdukur në diktaturë.

Janë marrë nisma konkrete dhe janë organizuar aktivitete në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve, Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Ditës së Përkujtimit të Viktimave të Regjimeve Totalitare, duke bashkëpunuar me institucionet dhe Prokurorinë për fillimin e procedurës së gjetjes dhe identifikimit të vendvarrimeve të personave të zhdukur në diktaturë.

Në bashkëpunim me qeverisjen lokale janë paraqitur propozime për kthimin në vende kujtese:

- të Kampit të Tepelenës (1949-1951), bazuar në Urdhrin nr. 45, datë 6. 6. 2017 për “Ngritjen e grupit të punës për kërkimin e dokumentacionit arkivor për Kampin e Tepelenës dhe krijimin e një memoriali për përkujtimin e datës 30 gusht si Dita Ndërkombëtare e të Zhdukurve”.

- të Mënikut (në Pezë), ku u zhvarrosën eshtrat e 22 intelektualëve të pushkatuar pa gjyq më 26 shkurt 1951, vendvarrim masiv i shumë të dënuarve nga diktatura, bazuar në propozimin e Autoritetit për këshillin bashkiak të Tiranës, për kthimin në vend të ndërgjegjes. Tashmë, rruga që të çon atje mban emrin “26 shkurti”.

Me propozim të AIDSSH-së, Presidenti i Republikës, ka nderuar me titullin “Për merita të veçanta civile” dinjitetin njerëzor të 14 personave që u përballën pa bujë me sistemin komunist, duke trajtuar njerëzisht familjarët e tyre të zhdukur, më 23 gusht 2018 në kampin e Tepelenës, më 25 shkurt 2019, për zbulimin dhe zhvarrimin e 22 intelektualëve të ekzekutuar pa gjyq për “bombën” në legatën sovjetike dhe më 30 gusht 2019, viktimat e para të kampit të Tepelenës.

Në bashkëpunim me Fondacionin Kujto.al, është realizuar filmi “Të zhdukurit” i gazetares Luljeta Progni, i mbështetur në dëshmi dhe dokumente arkivore mbi të zhdukurit në komunizëm, i cili zbuloi histori të të zhdukurve dhe hodhi dritë mbi personalitete frymëzuese, të panjohur më herët për shoqërinë shqiptare.

Është realizuar ekspozita “E shkuara e pakryer” e AIDSSH me gazetaren Fatmira Nikolli, me profile të të zhdukurve, hartën dhe listën e vendvarrimeve të raportuara, që e vuri theksin tek e drejta për të ditur dhe e drejta për të vërtetën, që nuk mund të vijë pa angazhimin aktiv dhe marrjen e përgjegjësisë së institucioneve.

Është pranuar projekti i përbashkët ICMP-AIDSSH “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimit: të zhdukurit në komunizëm” 2020-2021, i mbështetur nga BE, i cili synon të hartojë

dhe publikojë një udhëzues mbi të drejtat dhe detyrimet e legjislacionit shqiptar e ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut, sa u takon personave të zhdukur në diktaturë për shkaqe politike dhe shkelje të të drejtave të njeriut. Udhëzuesi do të mbështetet me takime informuese, mbledhje të dëshmimeve dhe punë kërkimore në arkiva, për qartësimin e fatit të tyre.

Është përgatitur raport për veprimtarinë mbi të zhdukurit pranë Grupit të Zhdukjeve me Forcë në Kombet e Bashkuara, për përmbushjen e rekomandimeve përkatëse, koordinuar nga MPJ.

AIDSSH do t’i propozojë Kuvendit të Shqipërisë përmirësime ligjore për të koordinuar më mirë punën mbi të zhdukurit, mes institucioneve, qeverisjes vendore, prokurorisë dhe familjeve.

**Publikimi i vendimeve dhe materialeve të miratuara nga Autoriteti, në funksion të transparencës dhe informimit për procesin vendimmarrës, duke respektuar kufizimet e legjislacionit të fushës për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale.**

AIDSSH me Vendimin e Autoritetit nr. 22, datë 22.02.2019, ka miratuar “Rregulloren e publikimit të veprimtarisë së Autoritetit në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj”. Qëllimi i kësaj rregulloreje është publikimi i veprimtarisë së Autoritetit në faqen zyrtare dhe përmes buletinit (në letër apo online), përcaktimi i procedurave organizative dhe teknike, si dhe marrja e masave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurisë së tyre për aq sa është e mundur, nëpërmjet kryerjes së procesit të anonimizimit të këtyre të dhënave që përmbajnë materialet që do të publikohen. Për certifikimin e kësaj Rregulloreje dhe për

efekte sigurie, për të qenë më korrektë dhe më të mbrojtur, ky proces ka kaluar nëpërmjet konsultimeve të vazhdueshme me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Janë publikuar vendimet janar-dhjetor 2019 që mund të gjenden në <http://autoritetidosjeve.gov.al/vendime-2019/>.

Krahas kësaj, janë publikuar online në faqen zyrtare të Autoritetit të gjitha vendimet e KDZH-së për deklasifikimin e dokumenteve, të cilat mund të gjenden në <http://autoritetidosjeve.gov.al/deklasifikime-2019/>; të gjitha aktivitetet e Autoritetit, të cilat mund të gjenden në <http://autoritetidosjeve.gov.al/njoftime-per-shtyp/>.

**Përfundimi sa më parë i procesit të implementimit dhe zhvillimit të sistemeve të menaxhimit të çështjeve dhe arkivit digjital, që do të shërbejnë në drejtim të mirorganizimit dhe lehtësimit të të gjithë procesit të punës në institucion.**

Në zbatim të kërkesave të lëna nga rezoluta e Kuvendit, Sektori i Zhvillimit Teknologjik ka rishikuar kriteret dhe specifikimet teknike të sistemit të menaxhimit të çështjeve dhe arkivit digjital. Gjithashtu është kryer testimi i tregut, për të përcaktuar çmimet e referencës së projektit.

Në mungesë të fondeve nga buxheti i shtetit, AIDSSH ka aplikuar për gjetjen e financimeve nga burime të tjera. Në këtë kuadër është përgatitur një projektpropozim për financim pranë Ambasadës Suedeze. Projektpropozimi është pranuar dhe financuesi ka nënshkruar marrëveshjen në gusht 2019. Gjatë vitit 2020 do të kryhen procedurat e prokurimit për blerjen dhe instalimin e sistemit të arkivit elektronik.

Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve, për shkak të mungesës së fondeve nga buxheti i shtetit, është i pamundur të realizohet. Për përmbushjen e kësaj pike jemi në fazën e kërkimit të donatorëve të tjerë.

**Konsolidimi i bashkëpunimit me ISKK-në, me fokus të veçantë çështjet që kanë të bëjnë me aksesimin e arkivave nga dy institucionet:**

Përgjatë vitit 2019, AIDSSH ka pasur bashkëpunim me ISKK, në mënyrë të veçantë për realizimin e konferencës shkencore “Fytyrat e “Armikut” të popullit” dhe përgatitjen e konferencës “Emigracioni politik shqiptar 1944-1990”. ISKK ka bashkëpunuar duke qenë pjesë e këshillit shkencor të konferencave dhe me paraqitjen e punimeve përkatëse. ISKK është ftuar të jetë bashkorganizatore në të gjitha aktivitetet përkujtimore të organizuara nga AIDSSH.

Për sa i përket qasjes në dokumentet arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit që ruhen dhe administrohen në arkivin e AIDSSH-së, duke vlerësuar rolin dhe rëndësinë që ka institucioni i ISKK, Autoriteti ka trajtuar dhe do të trajtojë me rigorozitet dhe përparësi të gjitha kërkesat që do të paraqiten nga ana e tyre. Për vitin 2019, pranë AIDSSH-së nuk është paraqitur asnjë kërkesë, ku subjekt kërkues të jetë ISKK.

**Vijimi i procesit të informimit, me qëllim rritjen e ndjeshmërisë publike ndaj krimeve të komunizmit përmes aktiviteteve, botimeve dhe në veçanti, pjesëmarrjes në media dhe rrjetet sociale, duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që ato luajnë në drejtim të transparencës dhe sqarimit të opinionit publik.**

Në përgjigje të kërkesës së rezolutës së Kuvendit, AIDSSH në bashkëpunim me partnerë vendas dhe të huaj, ka treguar gatishmëri në organizimin e aktiviteteve përkujtimore, të cilat janë vijuar me takime në terren me pushtetin lokal dhe komunitetin. Aktivitetet e zhvilluara në kuadër të Ditës Europiane të Përkujtimit të Viktimave të Sistemeve Totalitare kanë pasur për qëllim ndërgjegjësimin dhe informimin qytetar mbi kujtesën e viktimave të totalitarizmit, përkujtimin e të zhdukurve dhe nderimin e të mbijetuarve.

Konkretisht janë organizuar:

- Ekspozitë me materiale në zonën e Lushnjës;
- Dokumentim viziv dhe audiovizual i vendeve dhe profileve njerëzore e familjare të të dënuarve;
- Identifikim i vendeve të dënimit dhe shenjim në 11 kampet e punës së detyruar në Lushnjë;
- Ekspozitë dokumentare arkivore në zonën e Belshit;
- Shfaqje e filmit “Gratë mes dhunës e stigmës”, bashkëpunim me studiues dhe media;
- Bashkëbisedim i hapur me të mbijetuar dhe qytetarë;
- Aktiviteti përkujtimor i Ditës Europiane të Përkujtimit të Viktimave të Sistemeve Totalitare, zhvilluar në kampin e Tepelenës, ku u nderuan vuajtjet e të pafajshmëve, të internuar në kampin me tela me gjemba të Tepelenës në vitet 1949-1953;

Është pasuruar lista e botimeve të AIDSSH, pas mbledhjes së materialeve dhe organizimit të tyre në pjesën e parë të vitit:

Botime të realizuara nga aktivitete të ndryshme:

- a. Botimi i Punimit të Kënetës së Maliqit

- b. Botimi dygjuhësh ”Kur Sigurimi merrej me shkencë”.
- c. Botimi i punimeve të konferencës “Të mohuar nga regjimi”
- d. Botimi i raportit vjetor 2018
- e. Botimi i buletinëve të përdymuajshëm për vitin 2018
- f. Botimi online i ekspozitës së profileve njerëzore mbi të zhdukurit në diktaturë “E shkuara e pakryer”, [www.issuu/aidssh](http://www.issuu/aidssh).

Është vijuar puna me qëllim rritjen e ndjeshmërisë publike ndaj krimeve të komunizmit duke mbajtur në fokus të informimit studiuesit, median, grupet e interesit, si dhe të rinjtë, nëpërmjet aktiviteteve, botimeve, konferencave, dokumentarëve audiovizivë, etj.

1. Presidenti i Republikës, me propozim të AIDSSH, ka nderuar me titullin “Për merita të veçanta civile” dinjitetin njerëzor të 14 personave që u përballën pa bujë me sistemin komunist, duke trajtuar njerëzisht familjarët e tyre të zhdukur, më 23 gusht 2018 në kampin e Tepelenës, më 25 shkurt 2019, për zbulimin dhe zhvarrimin e 22 intelektualëve të ekzekutuar pa gjyq për “bombën” në legatën sovjetike dhe më 30 gusht 2019, viktimat e para të kampit të Tepelenës.
2. Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve, u realizua filmi “Të zhdukurit” i gazetares Luljeta Progni, një bashkëpunim i AIDSSH dhe Fondacionit Kujto.al, i mbështetur në dëshmi dhe dokumente arkivore mbi të zhdukurit në komunizëm, i cili zbuloi histori të të zhdukurve dhe hodhi dritë mbi personalitete frymëzuese, të panjohur më herët për shoqërinë shqiptare.



3. Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, AIDSSH, në bashkëpunim me IIPP dhe ICMP (Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur) zhvilluan ceremoninë e hapjes së ekspozitës mbi të zhdukurit në diktaturë “E shkuara e pakryer”, mbi të dhëna dhe materiale arkivore të AIDSSH e vetë familjeve, raportime të të zhdukurve dhe vendvarrimeve pranë AIDSSH, IIPP e ICMP, dhe intervista me familjarët.
4. U zhvilluan vizita pune për organizimin e Dialogut lokal në Voskopojë, Korçë e Maliq, në kuadër të bashkëpunimit me pushtetin lokal, takime që synojnë të përgatisin organizime komplekse e të genësishme mbi kujtesën në këtë zonë. Vizitat në terren, me përfaqësues të bashkisë dhe të përndjekur në këto zona, ndihmuan që të përcaktohen hapat konkretë që do të ndërmerren bashkërisht në 2020.
5. Në bashkëpunim me Bashkinë Përmet dhe Shoqatën Antikomuniste të të Përndjekurve Politike u zhvillua Dialogu i parë për Diktaturën në qytetin e Përmetit. U ekspozuan materiale arkivore të zonës, regjistra përpunimi, libra evidence, dosje përpunimi, hetimore-gjyqësore, dosje drejtimi të zonave të ndryshme të Përmetit, etj., duke i dhënë mundësi komunitetit të njihet me to, dhe të aplikojë për informim individual e për qëllime studimore. Bazuar në këto dokumente, u prezantuan tipologji të dosjeve të përndjekjes, duke ndërvepruar me të pranishmit, që ndanë edhe përvoja e përjetime personale.
6. U nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit midis AIDSSH dhe Fondacionit “Kujto” për Kujtimin e Viktimave të Komunizmit në Shqipëri, mes znj.

Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit dhe znj. Blerina Gjoka, Drejtore e Fondacionit, me objekt institucionalizimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit të ndërsjellë, për mbështetjen e kërkimit shkencor gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së Sigurimit, përmes krijimit dhe shpërndarjes së materialeve audiovizuale të krijuara bashkërisht.

7. U kryen vizita për shkëmbim përvojash në institucione homologe dhe në aktivitete sensibilizuese për përndjekjen në Shqipërinë komuniste, në Varshavë, Poloni: në Sofje, Bullgari, në Vjenë, Austri.

7.1. Takim pune me Rrjetin European të Arkivave të Policive Sekrete në Bratislavë, Sllovaki.

Të gjitha botimet e AIDSSH gjenden online në faqen [www.issuu.com/aidssh](http://www.issuu.com/aidssh) Kronikat, intervistat, dokumentarët mbi punën dhe veprimtarinë e AIDSSH pasqyrohen në vlogun në Youtube, Autoriteti i Dosjeve.

Në të njëjtën kohë, faqja zyrtare e AIDSSH është e lidhur me faqen Edhe muret kanë veshë, të dëshmime gojore të të mbijetuarve dhe [www.dosjet.gov.al](http://www.dosjet.gov.al) me profile personalitetesh mbi të cilët është hulumtuar dhe bërë studim multidisiplinar.

Vendimet e Autoritetit dhe veprimtaria e tij shpërndahen përmes faqes zyrtare në rrjete sociale në Facebook, Twitter dhe Instagram.

<http://www.autoritetidoseve.gov.al>

Facebook: <https://www.facebook.com/AutoritetiDosjeve/>

Instagram: [Autoriteti Dosjeve \(AIDSSH\)](https://www.instagram.com/AutoritetiDosjeve/)

Tëitter: <https://www.twitter.com/aidssh>

Youtube: [Autoriteti i Dosjeve](https://www.youtube.com/AutoritetiIDosjeve/)

# 05

VEPRIMTARIA E AIDSSH-SË  
PËR VITIN 2019

## 6.1 Aktiviteti i institucionit

Bazuar në Planin Strategjik 2017-2020, me Vendimin nr. 46, datë 22.06.2017, Autoriteti ka miratuar “Planin vjetor të punës për vitin 2019 të AIDSSH-së”. Mbi bazën e këtij dokumenti është mbështetur e gjithë veprimtaria institucionale e AIDSSH-së për vitin 2019, e cila është fokusuar në disa drejtime kryesore, si: pranimi dhe trajtimi i kërkesave për informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të paraqitura nga qytetarët apo institucionet publike, etj., ndërtimi i një institucioni të konsoliduar që ka në fokus rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj të gjithë subjekteve të ligjit 45/2015, krijimi i një arkivi të plotë, që synon të aplikojë standardet më larta për sa i takon sigurisë dhe shërbimit të dokumenteve arkivore, dhe rishqyrtimi historik i dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, përmes hulumtimit shkencor dhe edukimit qytetar, duke e hapur institucionin për të rinjtë dhe të interesuarit.

Arritja e objektivave të tillë kërkon burime njerëzore dhe financiare për t’u realizuar, të cilat kanë qenë të limituara që nga krijimi i AIDSSH-së. Në këto kushte, krahas detyrave funksionale, institucioni ka punuar shumë edhe në drejtim të gjetjes së mjeteve financiare të domosdoshme për arritjen e objektivave. Si rezultat i përpjekjeve të tremujorit të fundit të 2018, në fillim të vitit 2019 u finalizua projektpropozimi për financimin e rikonstruksionit të godinës së dhënë nga Qeveria Shqiptare si dhe blerjen e pajisjeve TIK për krijimin e një arkivi të integruar. Negociatat u mbyllën me sukses dhe në gusht 2019 u nënshkrua marrëveshja me Qeverinë Suedeze për financimin e projektit të propozuar.

Edhe përgjatë vitit 2019, arkivi i AIDSSH-së, sipas parashikimeve të VKM-së 98/2017 dhe marrëveshjeve të përbashkëta me institucionet përkatëse, ka qenë i lokalizuar në dy godina të ndryshme. Kjo situatë e ka vështirësuar së

tepërmi punën e përditshme të institucionit, pasi e gjithë veprimtaria e tij varet nga dokumentet arkivore. Megjithatë, brenda kushteve dhe rrethanave, janë marrë masa që ritmi i punës të mbahet në nivele të larta, në mënyrë të veçantë në trajtimin e kërkesave të ardhura nga institucionet publike dhe kushtetuese, kur kjo kërkohet në kuadër të vlerësimit, sipas legjislacionit përkatës, të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t’u emëruar ose ngritur në detyrë.

Vendimi nr. 95, datë 22.12.2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit” ka përcaktuar strukturën e AIDSSH-së, sipas së cilës, numri i punonjësve të tij duhet të jetë 60 në total. Gjatë vitit kalendarik 2019, Autoriteti ka funksionuar me 50% të strukturë/organikës, nga të cilët 5 janë anëtarë të Autoritetit (vendi vakant i krijuar nga dorëheqja e një anëtari të Autoritetit, akoma nuk është plotësuar nga Kuvendi) të zgjedhur nga Kuvendi sipas ligjit nr. 45/2015. Në këto kushte, stafi i AIDSSH, veç detyrave funksionale, sipas përshkrimit të punës, ka kryer edhe detyra të tjera të ngarkuara me vendime të Autoritetit dhe urdhra të brendshëm, duke u angazhuar në grupe pune specifike, në funksion të përmbushjes së objektivave kryesorë institucionale, dhe për të krijuar kushtet e nevojshme për përgatitjen e dokumentacionit për realizimin e mbledhjeve të Autoritetit, po ashtu edhe për organizimin e zhvillimin e aktiviteteve të shumta vjetore.

### 6.1.1 Arkivi

Në mbështetje të nenit 18 të ligjit nr.45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, nenit 40 të Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e AIDSSH-së,

Planit vjetor i punës për vitin 2019 të AIDSSH-së, Drejtoria e Arkivit gjatë vitit 2019 e ka fokusuar punën në disa drejtime kryesore, konkretisht:

- Inventarizimin e hollësishëm dhe marrjen në dorëzim të dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit nga institucionet arkivore të parashikuara në VKM 98/2017;
- Kërkimin dhe vënien në dispozicion të dokumenteve arkivore sipas kërkesave të miratuara nga Autoriteti, duke përfshirë i) kërkesat e institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike, lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, kur kjo kërkohet në kuadër të vlerësimit, sipas legjislacionit përkatës, të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t'u emëruar ose ngritur në detyrë, ii) kërkesat e paraqitura nga qytetarë të ndryshëm në cilësinë e të prekurit apo të të afërmit të prekurit, iii) kërkesa të paraqitura nga studiues dhe përfaqësues të mediave;
- Studimin dhe hartimin e relacioneve përkatëse për propozimin për deklasifikim të dokumenteve të klasifikuara, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8457, datë 11. 02. 1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”;
- Digjitalizimin e dokumenteve arkivore;
- Sigurinë, administrimin dhe shërbimin e dokumenteve arkivore për nevoja të brendshme të institucionit;
- Përgatitjen e ekzpozitave dokumentare, sipas temave të miratuara nga Autoriteti.

**Inventarizimi i hollësishëm dhe marrja në dorëzim e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit**

Procesi i inventarizimit të hollësishëm dhe marrjes në dorëzim të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit ka qenë i fokusuar kryesisht në dokumentet që ruhen në Arkivin e Sistemit të Ministrisë së Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme e Arkivave, Shërbimin e Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

### **Arkivi i Sistemit të Ministrisë së Brendshme**

Gjatë periudhës mars-qershor 2019, grupi i punës ka kryer procesin e inventarizimit të hollësishëm të dokumenteve të Fondit nr. 1, Dosje Hetimore-Gjyqësore. Gjatë këtij procesi janë verifikuar dhe inventarizuar 15 539 dosje, të vendosura në 901 kuti, dhe të dhënat e tyre, të cilat janë pasqyruar në tabelat përkatëse elektronike. Në përfundim të procesit është përgatitur procesverbali i marrjes në dorëzim të dokumenteve arkivore, në të cilin janë evidentuar dosjet që mungojnë. Jemi në pritje të firmosjes së procesverbalit nga pala dorëzuese, stafi i Arkivit të Sistemit të Ministrisë së Brendshme. Përveç fondit të mësipëm, grupet e përbashkëta të punës kanë evidentuar dhe kanë kryer verifikimin fizik të fondeve të mëposhtme:

1. Fondit nr. 132, “Dega e Sigurimit të Naftës”, nga ku rezultoi se ky fond ka gjithsej 254 dosje me dokumente arkivore të vendosura në 4 (katër) kuti. Këto kuti janë të numërtuara 3, 4, 5 dhe 7. Dokumentacioni është i painventarizuar dhe i përket viteve 1978-1983.
2. Fondi nr. 49, “Hetuesia”, nga ku rezultoi se ky fond ka gjithsej 203 dosje me dokumentet që i përkasin viteve 1950-1975, dhe janë të vendosura në 4 kuti.
3. Fondi nr. 128 “Brigada e Sigurimit të Shtetit”, nga ku rezultoi se ky fond ka 222 dosje me dokumentet arkivore që përkasin viteve 1949-1973, të vendosur në 4 kuti.

4. Janë identifikuar dhe verifikuar fizikisht dokumentet ish-Degëve të Sigurimit në Ushtri (DSU), gjithsej 54 kuti me 2456 dosje me dokumente arkivore..
5. Është bërë konsultimi i inventarit të Fondit 135 “Komiteti i Partisë së Punës së MPB”, vitet 1945-1991. Ky fond ka 637 dosje me dokumente arkivore të vendosura në 44 kuti dhe është i inventarizuar. Jemi në pritje të dorëzimit të dokumenteve të këtij sipas përcaktimeve të ligjit 45/2015.
6. Fondi 144 “Ngjarjet e 2 korrikut 1990”. Është një kuti me dokumentacion si dhe dosarë alfabetikë, të cilët kanë brenda kartelat me të dhëna dhe fotografi të shtetasve të ndryshëm.

Fondet e mësipërme janë refuzuar të dorëzohen nga stafi i Arkivit të Sistemit të Ministrisë së Brendshme. Për këtë çështje është vënë në dijeni Autoriteti, dhe më pas është komunikuar me shkresë zyrtare me Ministrinë e Brendshme. Jemi në pritje të përgjigjes nga Ministria. Procesi i marrjes në dorëzim i dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit nga ASMB është pothuajse i bllokuar që nga muaji maj 2019. Për zgjidhjen e kësaj situatë, në mbështetje të ligjit 45/2015 dhe VKM 98/2017, ka vijuar komunikimi me Ministrinë e Brendshme.

### **Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave**

Janë marrë në dorëzim nga SHÇBA këto materiale arkivore:

1. Dosjet e bashkëpunëtorëve të OSSH-së, gjithsej 113 dosje (pune + personale) me 3321 fletë,
2. Dosjet O.R.V dhe Dosje kërkimi/drejtimi, gjithsej 19 dosje me 1307 fletë.
3. Dosjet e punonjësve të O.R.V-ve.
4. Dosarë me fashikuj për ish punonjës të strukturave të ndryshme të MPB, gjithsej 1279 dosar me fashikuj.

5. Evidenca operative dhe regjistër i veprimeve me T.O, etj.

### **Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave**

Ka përfunduar ndarja në vite e dokumentacionit të fondit “Hetuesi e përgjithshme”, nga ku ka rezultuar se viti 1971-1985 ka gjithsej 143 kuti me dokumente arkivore, dhe viti 1987 ka gjithsej 49 kuti me dokumente arkivore. Procesi është në vijim.


### **Kërkimi dhe vënia në dispozicion e dokumenteve arkivore sipas kërkesave të miratuara nga Autoriteti**

Drejtoria e Arkivit është përgjegjëse për kërkimin dhe vënien në dispozicion të dokumenteve arkivore për të gjitha tipet e kërkesave të legjitimuara nga Autoriteti.

Në kushtet aktuale, ku dokumentet arkivore ruhen në dy vendndodhje të ndryshme (IPQP dhe SHISH) dhe administrohen respektivisht nga Sektori i Ruajtjes së Fondeve dhe Sektori i Përpunimit, trajtimi i tyre realizohet nga të dy sektorët, të cilët përgjigjen respektivisht për kërkimin, gjetjen dhe vënien në dispozicion të dokumenteve arkivore që kanë nën administrimin e tyre.

Viti 2019 ka filluar me 116 kërkesa të mbartura nga viti 2018, kërkesa të ardhura gjatë muajve të fundit të viti 2018. Gjatë vitit 2019, Drejtoria e Arkivit ka përfunduar 116 kërkesat e vitit 2018 dhe trajtuar në total **936** kërkesa të reja të vitit 2019, nga të cilat 135 kërkesa të paraqitura nga institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike institucionale, sipas së cilave kërkohet verifikimi i 286 shtetasve në lidhje me vlerësimin e cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve/zyrtarëve përpara emërimit apo ngritjes në detyrë; 506 kërkesa individuale të paraqitura kryesisht nga të prekurit apo nga të afërmit e të prekurve; 158 kërkesa për pajisjen me vërtetim për periudhën e internimit dhe/apo burgimit, 29 kërkesa për zbardhjen e


bashkëpunëtorëve dhe 105 kërkesa studimore. Në figurën më poshtë janë evidentuar numri i kërkesave të legjitimuara nga Autoriteti dhe të përcjella për trajtim pranë Drejtorisë së Arkivit gjatë vitit 2019.



### Deklasifikimi i informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”

Një tjetër proces pune shumë i rëndësishëm, i cili kryhet nga Drejtoria e Arkivit sipas përcaktimeve të ligjit nr.8457, datë 11.2.199, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dalta në zbatim të tij është studimi i dokumenteve të klasifikuar dhe përgatitja e praktikave të plota për mbledhjet e KDZH-së.

Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar 35 mbledhje të KDZH-së, ku janë marrë 35 vendime, nëpërmjet të cilave KDZH ka vendosur të deklasifikojë rreth **561** dosje me **92 777** fletë dokumentesh, sikurse ilustron më poshtë:




Bibliografite e dokumenteve të deklasifikuara i janë dërguar DSIK-së dhe janë publikuar në faqen zyrtare të AIDSSH-së në linkun <http://autoritetidosjeve.gov.al>.

### Digjitalizimi i dokumenteve

Digjitalizimi i dokumenteve ka qenë dhe vazhdon të jetë hallkë e domosdoshme në procesin e trajtimit të kërkesave dhe informimit të qytetarëve e institucioneve mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Ky proces është i rëndësishëm dhe

gjatë vitit 2019 ka konsistuar në digjitalizimin e dokumenteve dhe mikrofilmave në përmbushjen e kërkesave të ardhura nga individët, institucionet, studiuesit dhe media. Pas procesit të digjitalizimit, dokumentet i janë nënshtruar procedurave të mëtejshme të trajtimit të tyre, siç është anonimizimi i të dhënave sensitive dhe personale nga drejtoritë përkatëse.

Dokumentet e digjitalizuara ruhen në pajisje të specializuara (NAS dhe server), të cilat ofrojnë kapacitete ruajtjeje dhe mekanizmat e duhur të sigurisë. Arkivi digjital synon të shërbejë, jo vetëm për të përmbushur kërkesat për informim në dokumentet e ish-Sigurimit të adresuara deri më tani, por edhe si një gur themeli i platformës së komunikimit dhe ndërveprimit që synojmë të ndërtojmë, nëpërmjet së cilës, përdoruesit do të kenë mundësi kërkimi dhe shfrytëzimi të dokumenteve arkivore të krijuara nga strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit, të disponuara prej tyre apo që u janë vënë në përdorim, pavarësisht nga forma e ruajtjes veçanërisht, por pa u kufizuar në to, si dosje, të dhëna, shkresa, harta, plane, filma, regjistrime me figurë, me zë dhe regjistrime të tjera.



Për digjitalizimin dhe ruajtjen e dokumenteve dhe mikrofilmave janë përdorur pajisje digjitalizimi profesionale, të dhuruara nga Ambasada Gjermane. Gjatë vitit 2019 janë digjitalizuar rreth 1356 dosje me **216 000** dokumente

arkivore, nga të cilat 904 janë dosje fizike dhe 452 dosje të mikrofilmuara.

### Siguria, administrimi dhe shërbimi i dokumenteve arkivore për nevoja të brendshme të institucionit

Siguria e dokumenteve arkivore dhe mjediseve të arkivit është çështje shumë e rëndësishme dhe si e tillë është trajtuar, në përputhje me normat dhe rregullat e përcaktuar në legjislacionin në fuqi. Regjimi i hyrje/daljeve dhe i aksesit në dokumentet arkivore realizohet vetëm nga punonjësit e autorizuar, të cilët janë të pajisur me certifikatë sigurie, duke respektuar rregullat dhe duke evidentuar në mënyrë strikte veprimet e caktuara në regjistrat përkatës.

Shërbimi i dokumenteve arkivore për qëllime dhe sipas kërkesave të brendshme është realizuar në përputhje të plotë me ligjin 45/2015, Rregulloren “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, ligjit “Për arkivat”, Normat Teknike Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, të ndryshuar dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre.

### 6.1.2 Informacioni

Një nga përgjegjësitë e Autoritetit, sipas nenit 10 të ligjit nr. 45/2015 është dhënia e informacioneve dhe e njoftimeve mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe garantimi, shqyrtimi dhe dorëzimi i tyre të kërkuarit. Ligji parashikon në tërësinë e tij garantimin e të drejtës për informim për personat për të cilët ish-Sigurimi i Shtetit ka mbledhur të dhëna, për bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit të Shtetit, të favorizuarit, institucionet, të interesuarit për qëllime hulumtuese, historike e të rivlerësimit politik dhe mediat. Përcaktimi i rregullave dhe procedurave të detajuara sipas subjektit kërkues garanton për çdo rast, të drejtën e jetës private të të tretëve, sipas


vlërësimit të interesave të ligjshme. Për vitin 2019, në zbatim të planit vjetor të punës, bazuar në objektivat e vendosur në Planin Strategjik 2017-2020 të Autoritetit, është mbajtur parasysh plotësimi i objektivave të Autoritetit në krijimin të lehtësirave në procedurat për institucionet publike dhe qytetarët që kërkojnë informacion. Në periudhën janar-dhjetor 2019 rezultoi se:

- Janë paraqitur **506** kërkesa individuale,
- Janë paraqitur **135** kërkesa institucionale, për verifikimin e 286 kandidatëve (shtetasve),
- Janë paraqitur **5** kërkesa individuale për qëllime rehabilitimi dhe dëmshpërblimi,
- Janë paraqitur **158** kërkesa individuale dhe institucionale ISSH-së për efekt pensionesh,
- Janë trajtuar dhe ndjekur me prioritet **351** kërkesa të mbartura nga viti 2018.

Gjatë periudhës objekt raportimi janë paraqitur për legjitimim, vlerësim, informim e kthim përgjigje, 833 kërkesa të reja, të cilat janë trajtuar me proces standard, nëpërmjet procedurës së rregullt, të shoqëruara me vendimmarrjen përkatëse, verifikimi dhe informimi i 851 individëve e subjekteve sipas kërkesave, ndërsa në 158 raste është proceduar me shkresë dhe vërtetim standard. Në zbatim të detyrimeve që burojnë nga objekti, qëllimi dhe misioni që ka ky institucion në zbatim të ligjit 45/2015, si dhe rregullorja, urdhrat dhe udhëzimet janë informuar në total 1090 individë. Në përmbledhje të shifrave, për vitin 2019 janë paraqitur për:

- Legjitimim, **534** kërkesa të reja individuale dhe të mbartura;
- Mbyllje procedure, **509** kërkesa, nga të cilat:
  - Me dokumentacion arkivor janë **248** kërkesa,
  - Pa dokumentacion arkivor janë **261** kërkesa.

- Janë përpunuar **69 413** faqe dokumentacion arkivor i digjitalizuar, nga të cilat **24 536** janë anonimizuar.



Gjithashtu, është punuar për përmirësimin e formularëve tip (që plotësohen nga individët apo subjektet e verifikuara) në kontekstin e sqarimit dhe dhënies së ndihmës subjekteve kërkuuese, urdhrave, udhëzimeve, vendimeve informuese për mënyrën e trajtimit për problematika të hasura në praktikën e përditshme të punës, si p.sh., kërkesat drejtuar Autoritetit me objekt lëshimit e vërtetimit për periudhën e internimit për efekt të përlogaritjes së pensionit të pleqërisë; apo vendime informuese për mënyrën e trajtimit dhe dhënies përgjigje kërkesave me objekt zbardhjen e pseudonimeve të bashkëpunëtorëve, skedën shoqëruese të dosjeve, etj.

Vështirësia më e madhe vijon të jetë zbardhja e bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit, për faktin se një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit të krijuar për këtë kategori, siç janë dosjet e punës dhe dosjet personale, në pjesën më të madhe tyre janë asgjësuar. Nga ana tjetër, vërehet se interesi për zbardhjen e bashkëpunëtorëve nga personat e prekur apo të afërt të tyre ka ardhur në rritje. E shprehur në shifra, pranë AIDSSH-së janë paraqitur gjithsej 60 kërkesa për zbardhjen e bashkëpunëtorëve, sipas së




cilave kërkohet zbardhja e 619 bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit.

Në ushtrim të detyrës dhe të gjithë veprimtarisë, Autoriteti, krahas garantimit të integritetit të procesit gjatë dhënies së informacionit, është përpjekur ta bëjë informacionin lehtësisht të aksesueshëm, të saktë, të plotë, në përputhje me ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën për Informim”.

Gjithashtu gjatë dhënies së informacionit është punuar me prioritet në kuadër të mbrojtjes së të dhënave. Në mënyrë të veçantë janë trajtuar të dhënat në përputhje me ligjin nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe të dhënat që përbëjnë informacion të klasifikuar.

#### Trajtimi i kërkesave për informim për institucionet apo autoritetet publike

Në zbatim të ligjit 45/2015, Autoriteti ka punuar në trajtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me vlerësimin e cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve/zyrtarëve përpara emërimit apo ngritjes në detyrë, kur kjo kërkohet nga institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike.



Gjatë vitit 2019 janë paraqitur nga institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike për legjitimim 135 kërkesa të reja, për

verifikimin e 286 kandidatëve, përpara emërimit, ngritjes në detyrë apo dekorim; Në numrin e kërkesave të reja nuk përfshihet trajtimi i disa kërkesave që ishin paraqitur për verifikim në vitin 2018, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Garda e Republikës, etj.

- Janë mbyllur procedurat e verifikimit për 342 kandidatë, nga të cilët 16 kandidatë figurojnë me dokumente të krijuara nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit.

Kërkesat e paraqitura në AIDSSH nga institucionet kushtetuese apo autoritetet publike janë trajtuar me prioritet në mbledhjet e Autoritetit, deri në përmbylljen e procedurës dhe kthimin e përgjigjes për rezultatet e verifikimit, institucioneve të cilat kanë paraqitur kërkesën.

Vetëm në dy raste, nga Autoriteti është vendosur ndërprerja e procesit të verifikimit të filluar.

Në lidhje me rastin e parë, bazuar në nenin 13 pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, kur Autoriteti vlerëson se dokumente të caktuara mund të gjenden pranë një autoriteti publik apo arkivi, u drejtohet atyre me kërkesë me shkrim për identifikimin dhe vënien në dispozicion të dokumenteve. Pika 4. “Kur autoriteti publik ose arkivi merr një kërkesë, sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij neni, i përgjigjet Autoritetit brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës, duke i vënë në dispozicion, sipas rastit, dokumentet ose kopje apo dublikata të tyre”.

Nga verifikimet e kryera deri tani, në materialet arkivore në dispozicion, duke mos pasur të plotësuar formularin e ri, konkretisht seksionin C të tij, ku pasqyrohen të dhënat për eksperiencat e mëparshme të punës dhe vitet përkatëse e për rrjedhojë, duke mos pasur orientim zyrtar për sa i përket viteve dhe institucioneve ku kanë punuar subjektet objekt verifikimi, Autoriteti u gjend në situatë të vështirë dhe pothuajse të pamundur për të realizuar kërkimin, sidomos kthimin e përgjigjes sipas kërkesave të nenit 29, pika 2, germa “c” të ligjit 45/2015.

Referuar situatës juridike të mësipërme të krijuar, në mungesë të dokumentacionit për kryerjen e verifikimeve të plota dhe mbylljen e procedurës, Autoriteti konstatoi pamundësinë e vijimit të procedurës së verifikimit dhe vendosi ndërprerjen e procedurës për 22 kandidatë të nivelit drejtues të institucionit kërkues.

Në lidhje me rastin e dytë referuar situatës juridike të krijuar për një kandidat, për shkak të dorëheqjes dhe pezullimit në ushtrimin e detyrës, bazuar në nenin 29 pika 1 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, Autoriteti vendosi ndërprerjen e procedurës së verifikimit, me arsyetimin se nuk është në kushtet e parashikuara për të vijuar procedurën në kuadër të vlerësimit, sipas legjislacionit përkatës, të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t’u emëruar ose ngritur në detyrë, sipas pikës b) “.....anëtarë të trupës së nivelit të lartë drejtues në administratën shtetërore dhe pozicione të barasvlershme me to”.

Institucionet kushtetuese apo autoritetet publike që kanë paraqitur kërkesa gjatë vitit 2019, që janë trajtuar pranë AIDSSH-së:

- Institucioni i Presidentit të Republikës,
- Kuvendi i Shqipërisë,
- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë,
- Këshilli i Lartë Gjyqësor,
- Prokuroria e Përgjithshme,
- Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit,
- Ministria e Brendshme,
- Departamenti i Administratës Publike,
- Shërbimi Informativ Shqiptar,


- Akademia e Shkencave të Shqipërisë,
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë,
- Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit,
- Bashki të ndryshme, etj.

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, me shkresa përkatëse për secilin subjekt, në zbatim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, neni 4 pika 1 gërma “b” neni 25 pika 1 gërma “a dhe c” nenet 36, 37 dhe 38 të tij, si dhe përcaktimeve të nenit 29 të Ligjit nr.45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ka kërkuar informacion për subjektet, nëse sipas përcaktimeve të ligjit nr. 45/2105 kanë qenë: persona në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm; anëtarë; bashkëpunëtorë ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit.

Në dispozitat e nenit 38 pika 1 gërma g) të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, parashikohet edhe kriteri për verifikimin nëse kandidati ka qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit 45/2015.

Ndodhur në kushtet e papërcaktueshmërisë apo të një përkufizimi të qartë në lidhje me përcaktimin e termit “anëtar” në ligjin nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, nga ana jonë është vlerësuar t’i jepet përparësi dhe prioritet interpretimit dhe kuptimit të termave në zbatim të ligjit tonë, si ligj për informim, duke njohur dhe informuar kërkuesit mbi çdo dokument dhe

të dhënë që ndodhet në arkivat në dispozicion, për aq sa është e mundur dhe në kohë të shkurtër, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga kërkesat e nenit 29 pika 2, mbi detyrimin e Autoritetit që t'u përgjigjet institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike për zyrtarin që emërohet ose ngrihet në detyrë, përkatësisht nëse: a) ka qenë ose jo person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm; b) ka qenë ose jo bashkëpunëtor aktiv i ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji; c) figuron ose jo në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.



Në procesin e vendimmarrjes, Autoriteti mori në konsideratë arsyetimin dhe analizën e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, sipas përmbajtjes së shkresës nr.79 prot., datë 23.07.2019, në përgjigje të shqetësimit të ngritur nga Autoriteti për mospërfshirjen e termit “anëtar” në asnjë nga parashikimet e ligjit nr. 45/2015. Në përmbajtje të shkresës së sipërcituar është vlerësuar se, qëllimi dhe fryma e ligjit kërkon verifikimin dhe kontrollin e figurës së subjektit edhe për sa i takon përfshirjes së subjektit në strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit. Gjithashtu, çmohet se termi “anëtar” ka

të bëjë me cilësitë e funksionit/ detyrës konkrete që ka pasur një funksionar në Sigurimin e Shtetit, duke e interpretuar rast pas rasti, në kuadër të platformës së punës operative dhe mënyrës organizative.

Në raport me vitin 2018, kur janë trajtuar 67 kërkesa të ardhura nga institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, nëpërmjet të cilave janë verifikuar 463 kandidatë apo zyrtarë, në vitin 2019 janë trajtuar 135 kërkesa të ardhura nga institucionet kushtetuese, nëpërmjet të cilave janë verifikuar 342 kandidatë, nga të cilët 326 kandidatë të pastër dhe 16 kandidatë figurojnë në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit ose bashkëpunëtorë.

Gjithashtu, nisur nga disa përvoja në të cilat ka pasur raste kur kanë ekzistuar të dhëna ose dokumente të krijuar nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit në emër të personave të cilët, më pas janë propozuar për medalje ose tituj nderi, në funksion të transparencës dhe mbrojtjes së interesit publik, në zbatim të ligjit nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, organet e pushtetit vendor japin dekorata dhe tituj nderi në rastet kur vlerësohet plotësimi i kushteve të përcaktuara sipas ligjit, është kërkuar bashkëpunimi midis institucioneve, në lidhje me paraqitjen e kërkesës për verifikim të kandidatëve përpara dekorimit ose dhënies së titujve të nderit, me qëllim zhvillimin e procedurave të verifikimit të pastërtisë së figurës të shtetasve të propozuar, për periudhën kohore nga 29 nëntor 1944 deri në datën 2 korrik 1991, si fushë e veprimit të ligjit 45/2015 me shkresë drejtuar çdo bashkie.

### 6.1.3 Hulumtimi Shkencor dhe Edukimi Qytetar

Drejtorja e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar mbështet kërkimin shkencor me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit, po ashtu edukimin

qytetar për demokraci, nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet, mediat dhe të interesuarit.

Gjatë vitit 2019 ka pasur rritje të numrit të kërkesave studimore dhe atyre të paraqitura nga media të ndryshme, po ashtu rritje dhe konsolidim të veprimtarive shkencore e përkujtimore, të organizuara në bashkëpunim me partnerë, institucione homologe, të mbijetuar e familjarë të viktimave të diktaturës, në koordinim të përhershëm me pushtetin qendror e lokal, grupet e interesit dhe mediat.

Nga 6 persona të miratuar në organikë, Drejtoria ka funksionuar me 1 specialist deri në muajin qershor, i cili ka mbuluar informimin e studiuësve dhe mediave, kontaktet me publikun, organizimin e konferencave dhe ka mbështetur në mënyrë substanciale organizimin e dialogëve në rang kombëtar e ndërkombëtar. Në muajin qershor, DMSHEQ-së i është shtuar drejtori dhe, për 6-mujorin e dytë, ka funksionuar me 30 % të organikës.

E ndarë sipas objektit të punëve të ndërmarra dhe të kryera në vitin 2019, në bashkëpunim me drejtori të tjera të AIDSSH, për të vijuar me institucione partnere, institucione publike, qendrore e vendore, grupe interesi, organizata kombëtare e ndërkombëtare, media, studiuës dhe të rinj të interesuar, veprimtaria e DMSHEQ ka pasur të bëjë me:

1. Informimin e studiuësve dhe mediave me materiale të ish-Sigurimit të Shtetit;
2. Përgatitjen e buletinëve të përdymuajshëm dhe publikimin e veprimtarisë së AIDSSH, në kuadër të transparencës;
3. Organizimin e konferencave shkencore dhe mbajtjen e kontakteve me partnerët;
4. Organizimin e dialogut lokal dhe aktiviteteve të tjera tematike brenda dhe jashtë vendit;
5. Vlerësimin e figurave frymëzuese për “Merita të veçanta civile” nga Presidenti i Republikës;

6. Trajtimin dhe avancimin e çështjes së të zhdukurve në diktaturë;

7. Projektet me partnerë;

8. Bashkëpunimin me mediat për shpërndarje të informacioneve mbi AIDSSH, pasurimin e faqes zyrtare të institucionit në ndërveprim me rrjetet sociale;

9. Botimet fizike dhe online të AIDSSH.

### **Mbështetja shkencore**

Mbështetja shkencore bazohet kryesisht në përpunimin e kërkesave individuale të studiuësve dhe medias për qëllime studimore dhe vënien në dispozicion të tyre të dokumentacionit arkivor të kërkuar. Ky proces është kompleks sa u takon kërkesave studimore, kur për një kërkesë vihen në dispozicion nga 1 deri në 400 dosje, për rrjedhojë merr kohën e vet, që nga kërkimi në arkiv, identifikimi i dosjeve, digjitalizimi, anonimizimi e vënia në dispozicion studiuësve.



#### **1. Informimi i studiuësve dhe mediave me materiale të ish-Sigurimit të Shtetit**

Gjatë vitit 2019, pranë DMSHEQ janë paraqitur **105 kërkesa** studimore /mediatike, për të cilat janë trajtuar afërsisht **1500 dosje** me interes mediatik dhe historik, nga:

- përfaqësues të institucioneve të kërkimit shkencor vendas dhe të huaj;
- historianë e studiuës të pavarur;
- studentë të niveleve të ndryshme të studimeve pasuniversitare;


Nga këto janë legjitimuar 103 kërkesa, 2 prej të cilave ka rezultuar të kenë mangësi në dokumentacion, dhe u është shtyrë legjitimimi;

- **85 kërkesa** janë paraqitur nga institucione të kërkimit shkencor dhe studiues.
- **20 kërkesa** janë nga institucione mediatike dhe gazetarë të pavarur dhe
- **96 kërkesa** janë bërë nga studiues dhe media vendase
- **9 kërkesa** nga studiues dhe media të huaja.
- Janë trajtuar mbi **50% e kërkesave të vitit 2019**, gjithsej **60 kërkesa** studimore, me **1500 dosje të vëna** në dispozicion.



- Janë trajtuar dhe mbyllur të gjitha kërkesat e **mbartura të vitit 2018**, në total **45 kërkesa**.

Gjatë trajtimit të secilës prej kërkesave, sektori përkatës ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me kërkuesit e dokumentacionit, duke u shpjeguar hap pas hapi fazat nëpër të cilat kalon praktika, si dhe duke i mbajtur të informuar rreth kërkesave të tyre e duke kërkuar informacione shtesë për verifikimin sa më të saktë të dokumentacionit të kërkuar. Të gjitha kërkesat e tjera në 2019 janë në shqyrtim.




Po ashtu, për mbarëvajtjen e hulumtimit janë siguruar kushtet për infrastrukturën e nevojshme për studiuesit, me qëllim aksesin sa më të gjerë për subjektet e interesuara në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Për këtë, sektori i kërkesave për studiues/media ka:

- Asistuar apo orientuar sipas ligjit subjektet kërkuese gjatë plotësimit të formularëve të aplikimit;
- Vënë në dijeni studiuesit/mediat lidhur kërkesat e veçanta që ata nevojitet të përmbushin për të aksesuar në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit;
- Informuar mbi vendimin nr. 93, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave, rreth tarifave të aplikuara për

studiuës/media, për vënien në dispozicion të dublikatave të dokumenteve të kërkuara;

- Informuar kërkuësit hap pas hapi mbi ecurinë e praktikave dhe mbajtja e komunikimit me ta në mënyrë konstante;
- Për të gjithë studiuesit, të cilëve u është vënë në dispozicion dokumentacioni i gjetur nga Drejtoria e Arkivit, është marrë vendim nga Autoriteti dhe është firmosur deklarata e konfidencialitetit nga studiuesi në prani të një punonjësi dhe një anëtar të AIDSSH-së, me të cilën studiuesi/kërkuësi merr përgjegjësinë e moskeqpërdorimit të informacionit të marrë nga dokumentet e vëna në dispozicion nga Autoriteti dhe trajtimin e të dhënave personale dhe sensitive konform ligjit.



Nga ana tjetër, në mbështetje të ligjit 45/2015, ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, ligjit për dokumentet e klasifikuara, ligjit për arkivat, etj., DMSHEQ bën anonimizim më të thelluar të të dhënave të individëve, përsa kohë që dosjet e kërkuara nga studiuesit dhe mediat janë objekt i publikimit të studimeve apo reportazheve mbi personalitete dhe ngjarje historike.

Gjatë vitit 2019, DMSHEQ ka marrë pjesë në 25 mbledhje, ku janë marrë rreth 124 vendime për vënie në dispozicion të dokumenteve të gjetura, janë hartuar e firmosur nga

kërkuësit në prani të një punonjësi të Sekretariatit Teknik po aq deklarata konfidencialiteti. Po ashtu, në mbledhje janë trajtuar të gjitha aktivitetet e institucionit, të cilat janë organizuar dhe koordinuar nga DMSHEQ.

## 2. Përgatitja e buletinëve të përdymuajshëm dhe publikimi i veprimtarisë së AIDSSH, në kuadër të transparencës

Paralelisht me punën për informimin e studiuesve dhe mediave, është zhvilluar puna për përgatitjen e buletinëve të përdymuajshëm, duke anonimizuar e shkurtuar vendimet e Autoritetit dhe duke i përgatitur për faqesje online dhe fizike. Vendimet janar-dhjetor 2019 janë publikuar në faqen zyrtare të AIDSSH dhe mund të gjenden në <http://autoritetidosjeve.gov.al/vendime-2019/>. Po ashtu, të gjitha aktivitetet e Autoritetit, të cilat gjenden në <http://autoritetidosjeve.gov.al/njoftime-per-shtyp/>.

## 3. Organizimi i konferencave shkencore dhe mbajtja e kontakteve me partnerët

### Konferencat shkencore

Më 17 maj 2019, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Institutin e Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit dhe Institutin për Integrimin e ish-të Përndjekurve Politikë organizoi konferencën ndërkombëtare shkencore me temë: "Fytyra e "Armikut të Popullit" gjatë diktaturës së proletaritetit në Shqipëri, 1944-1990". Konferenca u zhvillua në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar dhe ishte e hapur për publikun dhe mediat.

Organizatorë dhe përfaqësues të trupit diplomatik e mbështetën trajtimin të një subjekti të tillë në Shqipërinë postkomuniste, e cila ka nevojë ta rishikojë narrativën e

regjimit dhe t'i rivlerësojë viktimat, ende të përndjekura nga stigma. Znj. Sula, z. Marenglen Verli, z. Agron Tufa, z. Bilal Kola, znj. Elva Margariti, ministre e Kulturës dhe z. Petro Koçi, zv.ministër i Mbrojtjes, paraqitën këndvështrimet përkatëse dhe nevojën e shoqërisë shqiptare për njohje e studim të thelluar të së shkuarës, në praninë e studiuesve, kërkuesve shkencorë, përfaqësuesve të shoqatave të drejtave të njeriut, të universiteteve të vendit dhe studentëve, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve publike e joqeveritare.

Përfaqësitë diplomatike në Tiranë, të pranishme në ceremoni, z. Bernd Borchardt, Prezenca e OSBE-së, z. Johann Sattler, ambasador i Republikës së Austrisë, z. Alberto Cutillo, ambasador i Republikës Italiane, z. Karol Bachura, ambasador i Republikës Polake dhe znj. Monika Bylaite, Delegacioni European në Shqipëri, ftuan për reflektim përballë krimeve të së shkuarës.

Në vijim, në sesione paralele, “armiku i popullit” u trajtua nga pikëpamja filozofike, historike, politike, shoqërore, kulturore. Diskutimi teorik mbi konceptet “disidencë”, “disident”, “kundërshtar politik” u pasua nga lufta e klasave, tipologjia e njeriut të ri gjatë socializmit, sjellja e regjimit ndaj klerit katolik shqiptar, klerit ortodoks në Shqipëri, “armiku i djeshëm”, “kundërshtari i sotëm”; ngjashmëritë dhe dallimet në vizatimin e “armikut të popullit”; imperializmi amerikan-armik i përhershëm i regjimit komunist në Shqipëri; projektimi i “armikut të popullit” dhe ideologjia e tjetërsimit të individit; metamorfoza e “armikut të klasës” në radhët e Ushtrisë Popullore, nga “oficeri i dekluar”, tek “oficeri puçist dhe oficeri poliagjent”; koncepti i “armikut” në aktet politike në fundin e vitit 1990 dhe fillimet e vitit 1991; imazhe, armiq dhe vese në shoqërinë komuniste; tipologjia e “armikut të popullit” në art, në romanet e novelat me agjenturë të realizmit socialist; kleri si “armik i popullit” në letërsinë shqipe; përjashtimi nga historia e letërsisë, si dënim për shkrimtarët “armiq”; fati i revistave kulturore “reaksionare” pas vendosjes së diktaturës; disidencat shqiptare midis mitit dhe realitetit;

“çamët e pabesë” si kundërshtarë politikë të regjimit komunist e punime të tjera, me emra e profile konkrete “armiqsh të popullit”.

Në mbyllje u vendos që konferenca pasardhëse e AIDSSH me partnerë të trajtojë materiale të shumta arkivore të institucionit, duke hedhur dritë në “mitet” e së shkuarës, konkretisht mbi “Emigracionin politik shqiptar 1944-1990”.

b) Thirrja për konferencën mbi emigracionin dhe puna përgatitore me arkivin, komisionin shkencor e komunikimin ndërinstitucional u zhvillua përgjatë gjysmës së dytë të 2019. Konferenca u caktua më 19 shkurt 2020, në kuadër të aktiviteteve #Demokraci 30.

Puna për konferencat është paraprirë nga muaj të gjatë përgatitorë, ku thirrjes për të marrë pjesë u janë përgjigjur me dhjetëra studiues shqiptarë e të huaj. Komisioni i vlerësimit ka përzgjedhur punimet, duke i organizuar në panele të kërkimit shkencor dhe të kujtesës. Gjatë kësaj kohe, studiuesit kanë pasur mundësi të shfrytëzojnë inventarët, dosjet, statistikat dhe materialet e ndryshme arkivore të vëna në dispozicion nga AIDSSH apo të tjerë arkiva.

Për realizimin e konferencave, AIDSSH ka punuar për hartimin e dokumentacionit shkencor me institucione partnere; hartimin e planit të punës për organizimin dhe mbarëvajtjen e konferencës; relatimin dhe draftimin e vendimit për mbledhjen e Autoritetit për vijimin e punës dhe organizimin e konferencës; mbajtjen e komunikimeve të vazhdueshme me të gjithë aplikuesit për pjesëmarrje në konferencë e më tej me kandidatët fitues vendas dhe të huaj; organizimin e herëpashershëm i takimeve të komisionit organizativ dhe shkencor; mbajtjen e komunikimit me të gjitha institucionet partnere për koordinimin e punëve dhe mbarëvajtjen e organizimit; mbledhjen e punimeve dhe orientimin e studiuesve në parametrat për shkrimin e punimeve; draftin e parë për botimin e librit përkatës.

## Kontaktet me partnerët

Përgjatë vitit 2019, AIDSSH ka firmosur 9 marrëveshje bashkëpunimi me partnerë, të cilat janë arritur nga komunikimi i vazhdueshëm me institucionet dhe shoqatat e interesuara për institucionalizim të veprimtarive me AIDSSH. Për këtë është punuar në koordinim të ngushtë me sektorin juridik, i cili ka hartuar marrëveshjet dhe i ka paraqitur në Autoritet.

## Shkëmbim përvojash me institucione homologe të Lindjes ish-komuniste

Në vijim të bashkëpunimeve me komunitetet brenda dhe jashtë vendit, AIDSSH zhvilloi një vizitë pune në **Poloni** më 27 mars – 31 mars, i ftuar nga Autoriteti homolog “Krzyżowa Foundation for Mutual Understanding in Europe”, në aktivitetin “Historitë e harruara”. Në seminar u trajtuan personalitetet e Sabiha Kasimatit dhe Musine Kokalarit, si dhe ish-kampi i internimit i Tepelenës, duke bërë të qartë kontributin e Autoritetit në zbardhjen e historive përkatëse. Po ashtu, u zhvilluan takime me përfaqësues të Rrjetit European të Kujtesës dhe Solidaritetit (ENRS) për nxitjen e dialogut për historinë europiane të shekullit XX.

AIDSSH mori pjesë në takimin e përvitshëm në nivelit të lartë të Rrjetit European të Autoriteteve Zyrtare për Informimin mbi Dokumentet e Policive Sekrete, i mbajtur në **Sillovakia**, Bratislavë më 24-27 shtator. Në takime, AIDSSH paraqiti kërkesën për t’u anëtarësuar me të drejta të plota në Rrjetin European të Autoriteteve Zyrtare për Informimin mbi Dokumentet e Policive Sekrete, si dhe mori pjesë aktive në veprimtaritë me fokus hulumtimin shkencor dhe edukimin qytetar. “Sfidat e kërkimit shkencor të AIDSSH, në bashkëpunim me institucionet akademike dhe universitetet” u prezantuan për homologët e Lindjes, me angazhimin për të marrë pjesë dhe kontribuar në aktivitetet e Rrjetit, për të mbajtur gjallë kujtesën e së shkuarës, ku nuk mund të ketë pajtim, pa të vërtetë dhe përkujtim.

Në 11-15 nëntor, AIDSSH zhvilloi një vizitë pune në **Bullgari**, për shkëmbim përvoja mbi arkivat, proceset e dekodifikimit, digjitalizimin dhe ruajtjen e materialeve me rëndësi historike për proceset tranzicionale të vendit. Të gjitha fazat nëpër të cilat kalon AIDSSH për trajtimin e materialit arkivor u panë në përvojën e homologëve.

## Edukimi qytetar

Mbështetur në kalendarin e kujtesës dhe në detyrat e caktuara nga rezoluta e Kuvendit, AIDSSH ka ndërmarrë dhe organizuar një sërë projektesh e aktiviteteve gjatë vitit 2019, ku rishqyrtimi historik ka shërbyer si mjet për inkurajimin e dialogut social, në emër të transparencës dhe konsolidimit të demokracisë. Studimi i plotë dhe i thelluar i burimeve arkivore autentike të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit është një proces i gjatë dhe i vazhdueshëm. Ndërkohë, ai është mjeti i vetëm që do të garantojë rishqyrtimin e historisë së errët të strukturave dhe makinacioneve të përdorura nga regjimi komunist për më shumë se 45 vjet në Shqipëri.

Më poshtë janë renditur nismat e ndërmarra dhe aktivitetet nëpërmjet të cilave, Autoriteti ka komunikuar me qytetarët dhe të interesuarit, sa u takon ngjarjeve përkujtimore apo personaliteteve historike.

### 1. Organizimi i dialogut lokal dhe aktiviteteve të tjera tematike brenda dhe jashtë vendit

Gjatë vitit 2019, sipas kalendarit të kujtesës, AIDSSH ka zhvilluar veprimtari përkujtimore në të gjithë vendin. Veç hapjes së dosjeve dhe ekspozitave dokumentare në qytetet përkatëse, AIDSSH ka organizuar takime të hapura me komunitetet lokale, brenda dhe jashtë vendit.

### Aktivitete përkujtimore në Gjirokastër



12 shkurt - "Gjirokastra lexon Musinenë". Hedhja dritë mbi figurën e shkrimtares së mirënjohur Musine Kokalari, trajtimi i figurës së saj në dimensionin e krijimtarisë letrare dhe jeta e vështirë në përndjekje, u diskutuan në një takim të organizuar me pushtetin lokal, familjarët dhe grupet e interesit. Në përfundim, u pasurua dhe saktësua profili i saj në Wikipedia nga të rinjtë e pranishëm, u zhvillua vizitë në shtëpinë e Musinesë dhe vizitë në burgun e Gjirokastrës, i denoncuar për numrin e madh të të zhdukurve në komunizëm.

### **Pezë-Mënik, Tiranë**

20-26 shkurt - Aktivitete mbi shpalljen vend kujtese në Pezë-Mënik të vendit ku u ekzekutuan 22 intelektualë, me akuzën e hedhjes së bombës në Ambasadën Sovjetike,

-Shfaqje e instalacionit "Edhe muret kanë veshë" në ballinën e Muzeut Historik Kombëtar, në përvjetorin e rrëzimit të shtatores së diktatorit.

-Emërtimi "26 shkurti" i rrugës për në vendekzekutimin e tyre, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës. Nënkryetari i bashkisë, z. Andi Seferi mori pjesë në ceremoninë protokollare me praninë e familjarëve të të ekzekutuarve, komunitetit lokal, të rinjve të zonës dhe përfaqësuesve të shoqatave të të drejtave të njeriut.

-Ceremonia e vlerësimit me tituj nderi "Për merita të veçanta civile" nga Presidenti i Republikës e 6 njerëzve të përfshirë në zbardhjen, përkujtimin dhe dokumentimin e ngjarjes së 26 shkurtit.

-Shfaqja e filmit mbi të ekzekutuarit e 26 shkurtit për të rinjtë e gjimnazeve të Tiranës në teatrin "Metropol".

**Aktivitetet "Dinjiteti përballë totalitarizmit"** në Lushnjë, Belsh, Tepelenë e Tiranë, të zhvilluara në kuadër të Ditës Europiane të Përkujtimit të Viktimave të Sistemeve Totalitare dhe Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve u mbështetën mbi ndërgjegjësimin dhe informimin qytetar për kujtesën e

viktimave të regjimeve totalitare dhe autoritare, përkujtimin e të zhdukurve dhe nderimin e të mbijetuarve.

### **Dinjiteti përballë totalitarizmit, Lushnjë**

18 gusht - Në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë dhe njësitë administrative të fshatrave të ish-të internuarve, me shoqatat e të përndjekurve, të mbijetuar e familjarë të tyre, AIDSSH zhvilloi fazën e parë të Dialogut lokal në zonë. Homazhet në Memorialin Kombëtar të të Internuarve i paraprinë takimit të përvitshëm në teatrin e qytetit "Vaçe Zela", të ish-të internuarve në fshatrat e Lushnjës. Paralelisht dialogut të hapur u zhvillua ekspozita e profileve njerëzore "Historitë e patreguara të Lushnjës" dhe ekspozita dokumentare me materiale në zonën e Lushnjës.



*Ekspozita dokumentare me materiale në zonën e Lushnjës.*

Takimit i parapriu puna paraprake për dokumentimin viziv të vendeve dhe profileve njerëzore e familjare të të dënuarve, po ashtu shenjimi i vendeve të dënimit në kampet e punës së detyruar në Lushnjë, i realizuar nga AIDSSH dhe bashkëpunëtorë, gjatë muajit qershor.



*Ekspozita e profileve njerëzore “Historitë e patreguara të Lushnjës”*

### **Dinjteti përballë totalitarizmit, Belsh**

21 gusht - Në bashkëpunim me Bashkinë Belsh, grupe të interesit dhe të mbijetuar të përndjekjes, AIDSSH zhvilloi fazën e parë të Dialogut lokal në Belsh, zonë e të internuarve

të shpërngulur nga kampi i Tepelenës e të tjerë, si dhe e burgut të grave, mes të cilave të dënuara të ndërgjegjes. Në shëtitoren e qytetit u prezantua ekspozita dokumentare me materiale arkivore të zonës së Belshit e burgut të grave dhe u shfaq filmi “Gratë mes dhunës e stigmës”, bashkëpunim i AIDSSH me studiuesen Fiona Todhri dhe Tring TV.

Takimi vijoi me bashkëbisedim të hapur me të mbijetuarit dhe qytetarët, pas ekspozitës dhe shfaqjes së filmit.

*Ekspozita dokumentare me materiale të zonës së Belshit e burgut të grave*



*Shfaqje e filmit “Gratë mes dhunës e stigmës”*

### **Dinjteti përballë totalitarizmit, Tepelenë**

23 gusht - Në vazhden e aktiviteteve të përvitshme të organizuara nga AIDSSH në kuadër të Ditës Europiane të Viktimave të Regjimeve Totalitare, në bashkëpunim me Bashkinë e Tepelenës, shoqata të të përndjekurve politikë, IIPP, të mbijetuar të kampit dhe familjarë të tyre u zhvilluan takime përkujtimore në kampin e Tepelenës, ku u raportuan vendvarrime të të miturve në rrethina të kampit.

Në vijim, në teatrin e qytetit u shfaq filmi “Azizi” i gazetares Luljeta Progni, i bazuar në jetesën në kamp, i pasuar nga një bashkëbisedim aktiv me të mbijetuar.

### **Dinjteti përballë totalitarizmit, Tiranë**

30 gusht - Me propozim të AIDSSH, Presidenti i Republikës vlerësoi me titujt “Për merita të veçanta civile” qytetarët e përfshirë në rastin e rrallë të zhdukurve të familjes Petrela, viktimat e para të kampit të Tepelenës, në Ditën Ndërkombëtare të Zhdukurve.

Në ceremoni u shfaq filmi “Të zhdukurit” i gazetares Luljeta Progni, bashkëpunim i AIDSSH me Fondacionin Kujto.al.

### **Dialog lokal për diktaturën në zonën e Konispolit**

20-22 shtator - Anëtarë të Autoritetit patën takime të hapura me komunitetin në Konispolit, në 60-vjetorin e masakrës në zonë, si fazë e zgjerimit të dialogut në të gjithë krahinën.

### **Dialogu lokal për diktaturën në Korçë e Maliq**

21-22 tetor – AIDSSH zhvilloi takime paraprake pune në Voskopojë, Korçë e Maliq, për Dialogun që do të organizohet në këtë zonë në 2020. Vizitat në terren, takimet me përfaqësues të bashkive dhe të përndjekur lokalë ndihmuan të përcaktohen hapat konkretë që do të ndërmerren bashkërisht në 2020, ku pati angazhime institucionale nga Bashkia Korçë, Qendra e Artit, Shoqata e të Përndjekurve në Korçë e Bashkia Maliq. Vizitat e punës dhe takimet synojnë të përgatisin organizimet komplekse e të qenësishme mbi kujtesën në këtë zonë gjatë vitit pasardhës.

Kontaktet me qytetarët, kërkesat për studim të profileve të personaliteteve, dhe kërkimi arkivor në 2019 kanë hedhur bazat për **Dialogun e Tiranës** në 2020, për 100-vjetorin e Tiranës kryeqytet.

### **Dialogu lokal për diktaturën në Përmet**

13 dhjetor - Në bashkëpunim me Bashkinë Përmet dhe Shoqatën Antikomuniste të të Përndjekurve Politikë u zhvillua Dialogu i parë për Diktaturën në qytetin e Përmetit. U ekspozuan materiale arkivore të zonës, regjistra përpunimi, libra evidence, dosje përpunimi, hetimore-gjyqësore, dosje drejtimi të zonave të ndryshme të Përmetit, etj., duke i dhënë mundësi komunitetit të njihet me to, dhe të aplikojë për informim individual e për qëllime studimore. Bazuar në këto dokumente, u prezantuan tipologji të dosjeve të përndjekjes, duke ndërvepruar me të pranishmit, që ndanë edhe përvoja e përjetime personale.

#### **a) Organizim i vizitave të punës së AIDSSH për takime me komunitetet brenda dhe jashtë vendit**

Përgjatë 2019 janë organizuar takime të hapura me komunitetin shqiptar në Belgjikë dhe SHBA. Një pjesë e synimeve të vëna gjatë këtyre vizitave vijon të ndiqet për vitin 2020.

### **Komuniteti shqiptar në Belgjikë**

Më 24-27 prill, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit zhvilloi një vizitë punë në Bruksel, me ftesë të Shoqatës së ish-të Përndjekurve Politikë Shqiptarë në Belgjikë dhe Këshillit Kombëtar Shqiptaro-European. Takimet u organizuan në vazhden e aktiviteteve me komunitetet shqiptare jashtë vendit, për informim mbi veprimtarinë e Autoritetit, në përputhje me strategjinë e komunikimit të institucionit. Simpoziumi mbi rolin e Sigurimit të Shtetit në diasporë dhe përndjekjen e orkestruar në komunitete të posaçme e hapën z. Lek Pervizi dhe z. Sulejman Gjana, në emër të Shoqatës së ish-të Përndjekurve Politikë Shqiptarë në Belgjikë dhe Këshillit Kombëtar Shqiptaro-European, duke sjellë për të pranishmit edhe përvojat individuale e familjare të mbijetesës, e më pas integrimin. Veprimtaria e AIDSSH-së, shtyllat sipas të cilave institucioni organizon punën e vet dhe mundësitë për

bashkëpunim u prezantuan nga kryetarja e AIDSSH-së, znj. Gentiana Sula, z. Simon Mirakaj, z. Marenglen Kasmi, anëtarë të Autoritetit, dhe z. Skënder Vrioni, sekretar i përgjithshëm. Diaspora e hershme e viteve '60 dhe ajo e vonë, shqiptarë me përvoja të ndryshme dhe mbresëlënëse në Shqipëri apo Belgjikë, u bënë bashkë në një takim informues, të dialogut dhe mundësive të thellimit tek e shkuara, për transparencë, shërim dhe parandalim të shkeljes së të drejtave të njeriut e totalitarizmit në të sotmen e të nesërmen e përbashkët. Formularë aplikimi u plotësuan nga të interesuarit dhe u hodhën bazat për vijimin e projektit të dëshmime gojore në Belgjikë, nëpërmjet gazetareve shqiptarë të angazhuar në mediat prestigjioze vendase.

### **Komuniteti shqiptar në SHBA**

Më 3-8 qershor, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit zhvilloi një vizitë pune në SHBA, me ftesë të Federatës Panshqiptare Vatra dhe Fondacionit Victims of Communism. Takimet u organizuan në vijim të prezantimit të veprimtarisë së Autoritetit për informim. Në bashkëpunim me Zërin e Amerikës, me të cilin AIDSSH nënshkroi marrëveshje, u mblodhën 6 dëshmi gojore të të përndjekurve nga Sigurimi në Shqipëri dhe Amerikë. Të intervistuarit jetojnë sot në SHBA dhe intervistat e tyre, pjesë e arkivit digjital të dëshmime gojore të AIDSSH, janë prezantuar edhe për publikun mbarëbotëror, duke hedhur dritë edhe mbi punën e institucionit me dosjet dhe të mbijetuarit e përndjekjes.

Diaspora e hershme e para '90 dhe ajo e vonë, shqiptarë me përvoja të ndryshme në Shqipëri apo SHBA, veç takimeve të posaçme, u bënë bashkë në një paradë madhështore në Nju Jork, në mbrojtje të të drejtave të komunitetit çam, përndjekja e të cilit është trajtuar më herët nga AIDSSH. Projekti i dëshmime gojore synohet të vijojë për të pasuruar arkivin e dëshmime gojore, që vihet në dispozicion të qytetarëve dhe kërkuesve shkencorë, krahas dosjeve të Sigurimit të Shtetit për ta.

## **2. Vlerësim i figurave nga Presidenti i Republikës**

AIDSSH ka propozuar 11 personalitete për vlerësim për “Merita të veçanta civile”, pranë Presidentit të Republikës, në përvjetorin e masakrës së 26 shkurtit 1951 dhe në kuadër të 30 gushtit, Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve.

**Më 25 shkurt**, me propozim të AIDSSH, Presidenti i Republikës nderoi me titujt për “Merita të veçanta civile” dinjitetin njerëzor të personave të përfshirë në zbardhjen, përkujtimin dhe dokumentimin e ngjarjes së 26 shkurtit, tronditëse në historinë e shtetit komunist. Përmes një narrative të mbijetesës, respektit të heshtur, solidaritetit njerëzor dhe humanizmit pa bujë, të mbështetur në fakte, Autoriteti dorëzoi pranë Presidentit të Republikës kërkesën për vlerësimin e personaliteteve të thjeshta njerëzore, njëkohësisht, modele frymëzuese për shoqërinë e sotme shqiptare. Figurat e nderuara risjellin në vëmendje çështjet e vendvarrimeve të humbura dhe dinamikave njerëzore për zbulimin e së vërtetës dhe dokumentimin e saj: z. Kadri Hysa (pas vdekjes), z. Fasli Hysa (pas vdekjes), z. Gëzim Mullaj (pas vdekjes), z. Aleksandër Dhima, z. Hysen Shehu, z. Osman Kaceli.

Në kuadër të **30 gushtit**, Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve, AIDSSH i propozoi Presidentit të Republikës vlerësimin me tituj nderi “Për merita të veçanta civile” të personave të përfshirë në trajtimin njerëzor të viktimave të para të kampit të Tepelenës, Fadil dhe Xhuma Petrela, histori zhdukjeje dhe solidariteti e shtrirë në kohë, nga viti 1949 deri në 1993, ku triumfon dinjiteti i njerëzve të thjeshtë: z. Bujar Petrela, z. Ylber Petrela, z. Halil Petrela, z. Seit Petrela, z. Shqipjon Topulli (pas vdekjes).

Me nderim të thellë për aktet humane, qëndrueshmërinë ndaj kauzës familjare dhe finalizimin e saj me të gjitha nderimet. Me mirënjohje të veçantë për përfshirjen dhe angazhimin personal e njerëzor të pakursyer në zhvarrimin dhe dokumentimin e imtësishtëm të ngjarjes, me pjesëmarrje

aktive, të drejtpërdrejtë dhe thellësisht të ndjerë, duke përfaqësuar shembuj frymëzues njerëzorë të mbijetesës e karakterit, në vlerësim të shpresës së mbajtur gjallë dhe kurajës për të zbuluar të vërtetën, në emër të dinjitetit njerëzor.



*Presidenti i Republikës akordon tituj nderi "Për merita të veçanta civile"*

### 3. Trajtimi dhe avancimi i çështjes së të zhdukurve në diktaturë

Përgjatë 2019, AIDSSH ka zhvilluar dhe implementuar "Dialogjet lokale mbi diktaturën", në të cilat ka angazhuar të përndjekurit politikë, familjet e personave të zhdukur dhe institucionet lokale. Dialogjet kanë rezultuar iniciativë dhe instrument i suksesshëm, ku grupet e synuara kanë treguar prirje pozitive ndaj çështjes së drejtësisë tranzicionale.

Janë marrë nisma konkrete dhe janë organizuar aktivitete në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve, Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Ditës së Përkujtimit të Viktimave të Regjimeve Totalitare, duke bashkëpunuar me institucionet dhe Prokurorinë për fillimin e

procedurës së gjetjes dhe identifikimit të vendvarrimeve të personave të zhdukur në diktaturë (informacioni i plotë është trajtuar në kapitullin 4, për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit për vitin 2019, çështja e të zhdukurve)

### 4. Bashkëpunim me mediat, pasurim i faqes zyrtare të institucionit dhe ndërveprim me mediat sociale

Më 10 tetor 2019, u shfaq premiera e dokumentarit "Edhe muret kanë veshë" në kinema "Millenium", realizim i gazetares shqiptaro-amerikane Kristale Ivezaj Rama, artistes konceptuale Alketa Xhafa Mripa dhe regjisorit Ervin Kotori, projekt i zbatuar nga AIDSSH, për mbledhjen e dëshmimeve gojore në vend dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë për krimet e së shkuarës komuniste. Dëshmitë gojore u mbledhën në të gjithë Shqipërinë dhe instalacioni artistik u shpërfaq në fasadat e ndërtesave publike qendrore të 6 qyteteve, Tiranë, Shkodër, Berat, Tepelenë, Korçë, Gjirokastër.

Njëkohësisht, përgjatë vitit janë realizuar **dokumentarë** mbi dosje të arkivit të AIDSSH, në bashkëpunim me studiues dhe gazetarë të përmendur më sipër, si dhe reportazhe mbi veprimtarinë e Autoritetit nga televizione shqiptare dhe të huaja:

- France 24 dhe TV Monde 5, me dy reportazhe prezantojnë rolin e Autoritetit në drejtësinë tranzicionale në vend,

[https://www.youtube.com/watch?v=fD\\_J3ëM9CQA](https://www.youtube.com/watch?v=fD_J3ëM9CQA) po ashtu, televizionet kombëtare. [Top Channel Exclusive](#) dhe <http://ëëë.tematv.al/2019/03/01/autoriteti-i-dosjeve-arkivi-i-ish-sigurimit-t-shtetit-21-mij-dosje-t-hapura-studim-video>

Media vendase ka pasqyruar rregullisht veprimtarinë e institucionit, duke ndjekur aktivitetet përkujtimore, ekspozitat dokumentare si dhe vendimet e tij. Kjo ka bërë që AIDSSH të jetë e pranishme në televizionet kryesore në vend, me emisione me fokus dosjet e Sigurimit të Shtetit, dhe kronika

mbi punën e sfidat e përditshme në verifikimin e funksionarëve të lartë.

### **Faqja zyrtare e AIDSSH dhe ndërveprimi me mediat sociale**

Faqet e Autoritetit janë pasuruar e përmirësuar për të pasur ndërveprim sa më të mirë me ndjekësit:

Është publikuar faqja zyrtare e re zyrtare e AIDSSH, me ndërfaqe të reja dhe më të plota: [www.autoritetidosjeve.gov.al](http://www.autoritetidosjeve.gov.al)

Të trija faqet që administrojnë AIDSSH, faqja zyrtare [www.autoritetidosjeve.gov.al](http://www.autoritetidosjeve.gov.al), Edhe muret kanë veshë, e dëshmime gojore të të mbijetuarve dhe [www.dosjet.gov.al](http://www.dosjet.gov.al) me profile personalitetesh mbi të cilët është hulumtuar dhe bërë studim multidisiplinar, janë lidhur me njëra-tjetrën.

Të gjitha botimet e AIDSSH gjenden online në faqen [www.issuu.com/aidssh](http://www.issuu.com/aidssh) Kronikat, intervistat, dokumentarët mbi punën dhe veprimtarinë e AIDSSH pasqyrohen në vlogun në Youtube, [Autoriteti i Dosjeve](http://www.youtube.com/channel/UC9ëWa7a5vcokOVKEoi2PFLQ/) ku janë hedhur dhe shpërndahen videot e prodhuara nga Autoriteti me bashkëpunëtorët:

<https://www.youtube.com/channel/UC9ëWa7a5vcokOVKEoi2PFLQ/>

Vendimet e Autoritetit dhe veprimtaria e tij shpërndahen përmes faqes zyrtare në rrjete sociale në Facebook, Twitter dhe Instagram.

<http://www.autoritetidosjeve.gov.al>

Facebook: <https://www.facebook.com/AutoritetiDosjeve/>

Instagram: [Autoriteti Dosjeve \(AIDSSH\)](https://www.instagram.com/AutoritetiDosjeve/)

Tëitter: <https://www.twitter.com/aidssh>

Youtube: [Autoriteti i Dosjeve](https://www.youtube.com/channel/UC9ëWa7a5vcokOVKEoi2PFLQ/)

Materialet e hedhura në vlogun e AIDSSH në Youtube dhe të publikuara në faqen zyrtare janë shpërndarë gjerësisht nga

mediat sociale të AIDSSH që këtë vit janë zgjeruar në disa platforma virtuale: Youtube, Tëitter dhe Instagram e ISSUU.

Për të qenë sa më të pranishëm te të interesuarit, AIDSSH ka pasuruar mediat online, duke bërë publikime të shpeshta, prezantuar dosje e materiale arkivore, po ashtu, duke hedhur dritë në ngjarje me rëndësi historike. Për këtë janë përgatitur dhe shpërndarë njoftime për shtyp për çdo aktivitet të Autoritetit dhe në mbështetje të datave të kalendarit të kujtesës, të gjitha të konceptuara e hartuara për grupimet e synuara, të publikuara në faqen zyrtare dhe mediat sociale të Autoritetit.

### **5. Projekte me partnerë**

#### **Mbi rolin e shkencës në zhvillimin e shoqërisë gjatë viteve të para të vendosjes së regjimit komunist (1945-1954), me Ambasadën Zvicerane**

7 mars – AIDSSH dhe Projekti PERFORM - Shkenca Sociale Aktive dhe të Përgjegjshme, i Ambasadës Zvicerane bashkëpunuan përgjatë 2018 për ndërtimin e një narrative mbi rolin e shkencës, elitave intelektuale dhe kërkimit shkencor në vitet e para të vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri. Aktiviteti përmbyllës i projektit u zhvillua në mjediset e Akademisë së Shkencave, aty ku zuri fill një vit më parë dhe trajtoi në mënyrë multidisiplinore profilet e akademikëve Gjergj Kokoshi, Eqrem Çabej, Sabiha Kasimati, Arshi Pipa, Aleks Buda, Petraq Pepo, Gjovalin Gjadri, Petraq Qafoku dhe Kolë Kamsi.

Platforma ndërvepruese e komunikimit [www.dosjet.gov.al](http://www.dosjet.gov.al) dhe libri “Kur Sigurimi merrej me shkencë”, si produkte të projektit u bënë të njohura për të pranishmit duke prezantuar mundësitë e njohjes me informacionin mbi dosjet e Sigurimit nga të rinjtë, studiuesit apo të interesuarit e tjerë.

Nxjerrja në dritë e informacionit deri dje sekret dhe rikrijimi i kuadrit historik, nëpërmjet kërkimit të mbështetur shkencor, duke dhënë profilet e personaliteteve, duke ndërtuar kohështrirjen e jetës së secilit, duke e gërshetuar atë me

tablonë historike, politike, ideologjike e shoqërore të kohës është hapi i parë i projektit të mbështetur nga Ambasada Zvicerane. Intelektualët akademikë të dhjetëvjeçarit të parë të komunizmit do të pasohen nga profile të intelektualëve të dhjetëvjeçarëve vijues dhe tematika të tjera. Platforma do të pasurohet në vijim me informacion mbi Sigurimin e Shtetit, të vendosur gjithnjë në kontekst historik, duke qenë e aksesueshme për të gjithë, shqiptarë e të huaj dhe e dobishme në disa nivele njohjeje. Faqja është aktive me të gjitha recensat e punimeve, si dhe punimet e plota. <https://dosjet.gov.al/>

### **“Mendimi politik i së majtës”, me Fondacionin Friedrich Ebert Stiftung**

Në vijim – Projekti synon të kontribuojë në debatin mbi mendimin politik të së majtës shqiptare dhe trajton 10 profile që u përkasin rrymave të ndryshme të mendimit politik i së majtës.

E majta e sotme në Shqipëri ka si pjesë të trashëgimisë së saj historike jo vetëm luftën antifashiste, por edhe idetë e mendimet e Selaudin Totos, Musine Kokalarit, Gjergj Kokoshit e shumë të majtëve të tjerë që u përpoqën të themelonin një të majtë evropiane. Ndonëse duket sikur është shkruar e folur shumë për këtë pjesë të historisë së Shqipërisë, asnjëherë e majta shqiptare nuk është studiuar në thellësi dhe në të gjithë dimensionin e vet.

Qëllimi i projektit është që, nëpërmjet studimit të disa figurave themelore të së majtës së persekutuar shqiptare, të tregojë të gjitha dimensionet e historisë së të majtës në Shqipëri. Projekti ndihmon brezin më të ri të shqiptarëve për të kuptuar evoluimin e mendimit politik në Shqipëri. Gjithashtu hedh dritë mbi historinë e persekutimit komunist të shqiptarëve me bindje të majta, duke vendosur një gur tjetër në studimet për periudhën e regjimit komunist në Shqipëri.

Projekti i AIDSSH dhe FES finalizohet në 2020, me sesion shkencor mbi profilet e personaliteteve të përzgjedhura, botim

të studimeve shkencore, ekspozitë të profileve njerëzore dhe pasqyrim të tyre online në faqen e Autoritetit [www.dosjet.gov.al](http://www.dosjet.gov.al).

### **Të zhdukur në diktaturë, ekspozita “E shkuara e pakryer”, me Fondacionin Konrad Adenauer Stiftung**

11 dhjetor 2019 - Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, në bashkëpunim me ICMP, IIPP dhe e mbështetur nga KAS u prezantua në Muzeun Historik Kombëtar, ekspozita “E shkuara e pakryer”.

Ekspozita e punuar nga AIDSSH me gazetaren Fatmira Nikolli, me profile të të zhdukurve në diktaturë, hartën dhe listën e vendvarrimeve të raportuara, e vuri theksin te nevoja për bashkërendim të punës dhe marrje e përgjegjësisë së institucioneve. Përfaqësuesi i Grupit të Zhdukjeve me Forcë në Kombet e Bashkuara, z. Bernard Duhaime, i ftuar në ekspozitë, u shpreh se “për ta ruajtur sa më mirë kujtimin e viktimave, mbetet thelbësor zhvillimi i një strategjie për kujtesën, që merr parasysh rëndësinë e të ruajturit zyrtarisht të vendeve të mëparshme të paraburgimit dhe kampeve të punës si vende të kujtesës; si dhe shenjimi i vendeve, ngritja e përmendoreve e memorialeve për njohjen dhe rehabilitimin e viktimave.”

### **“Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimit: të zhdukurit në komunizëm” 2020-2021, ICMP-AIDSSH, i mbështetur nga BE**

Në nëntor 2019 u pranua nga BE projekti “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimit: të zhdukurit në komunizëm” 2020-2021, ku AIDSSH është bashkaplikues.

Projekti i përbashkët ICMP-AIDSSH synon të hartojë dhe publikojë një udhëzues mbi të drejtat dhe detyrimet e legjislacionit shqiptar e ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut, sa u takon personave të zhdukur në diktaturë për shkaqe

politike dhe shkelje të të drejtave të njeriut. Udhëzuesi do të mbështetet me takime informuese, mbledhje të dëshmive dhe punë kërkimore në arkiva, për qartësimin e fatit të tyre.

Po ashtu, në ekspozitë të profileve të të zhdukurve, dialogë lokalë ndërgjegjësues dhe botime të punës hulumtuese e dëshmive gojore dhe mbështetje e shoqatave e familjarëve të të zhdukurve në diktaturë.

## 6. Botime

Është pasuruar lista e botimeve të AIDSSH, me mbledhjen e materialeve dhe organizimin e tyre sipas punës hulumtuese e aktiviteteve përkujtimore tematike. Publikimet janë mbështetur në bashkëpunimin e AIDSSH me partnerë dhe studiues, duke rritur numrin e botimeve mbi të shkuarën në materiale arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit dhe burime të tjera arkivore që i përkasin të njëjtës periudhë, dëshmi të ish-të përndjekurve dhe të afërmeve të tyre.

Botimet janë paraqitje e veprimtarisë administrative të AIDSSH përgjatë 2019 (raport vjetor dhe vendime), po ashtu, publikime të studimeve të kërkuesve shkencorë, në bashkëpunim me Autoritetin, mbi tematika si përndjekja dhe mekanizmat e shtypjes në fushën akademike, industriale, punës së detyruar, vendeve të vuajtjes, apo profileve të të zhdukurve në diktaturë, ende të pagjetur:

- Raporti vjetor 2018, shqip dhe anglisht, fizik dhe online.
- Buletinët e përdymuajshëm për vitin 2018, fizikë dhe online.
- Studimi “E vërteta e inxhinierëve të Kënetës së Maliqit”, fizik dhe online.
- Libri dygjuhësh ”Kur Sigurimi merrej me shkencë”, në përmblyllje të projektit me PERFORM, fizik dhe online.
- Përmbledhja e punimeve të konferencës “Të mohuar nga regjimi”, fizike dhe online.

- Realizimi fizik i ekspozitës së profileve njerëzore mbi të zhdukurit në diktaturë “E shkuara e pakryer”, e publikuar online në shqip dhe anglisht në [www.issuu/aidssh.com](http://www.issuu/aidssh.com)

Paralelisht, janë mbledhur materialet dhe është përgatitur për botim drafti i parë i përmbledhjes së konferencës “Fytyra e ‘armikut të popullit’ në vitet 1944-1991. Të gjitha botimet janë lehtësisht të aksesueshme në faqen [www.issuu/aidssh.com](http://www.issuu/aidssh.com) e lidhur me faqen zyrtare të institucionit.

### 6.1.4 Siguria dhe Zhvillimi Teknologjik

#### Siguria fizike

Në funksion të zbatimit të ligjit nr. 45/2015, autoritetet publike i referohen dhe zbatojnë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, për aq sa është e mundur, edhe legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, arkivat dhe informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”. AIDSSH, gjatë veprimtarisë së tij është ndeshur me dokumente dhe informacione të klasifikuara dhe ka vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, sipas rastit dhe nivelit të klasifikimit.

Duke pasur parasysh se mbledhja, administrimi, përpunimi, përdorimi dhe informimi mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit udhëhiqet ndër të tjera, edhe nga parimet e mbrojtjes së interesit publik e sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes së të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar, është bërë plotësimi i kuadrit ligjor të brendshëm të institucionit, që ka të bëjë me mënyrën e ruajtjes fizike të dokumentacionit arkivor të ish-Sigurimit të Shtetit është një nga prioritetet për çdo vit pune.

AIDSSH prodhon dhe administron informacione të klasifikuara “sekret shtetëror”, të niveleve nga niveli më i ulët i klasifikimit “i kufizuar” deri në nivelin më të lartë të klasifikimit “tepër sekret”. Këto kategori informacionesh trajtohen vetëm në Zonat e Sigurisë. Me qëllim për të garantuar sigurinë e



informacioneve të klasifikuara dhe të ambienteve në të cilat prodhohen e administrohen kategoritë e lartpërmendura të këtyre informacioneve është hartuar Plani i Masave nga strukturat përgjegjëse.

Duke pasur parasysh faktin se aktualisht, AIDSSH e ushtron veprimtarinë në mjediset e vëna në dispozicion nga Garda e Republikës së Shqipërisë, pjesë e Planit të Masave për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar është “Skema e sigurisë fizike të këtij ambienti”. Aktualisht, për shkak të mungesës së ambienteve, fondi arkivor i AIDSSH-së ndodhet në vend ruajtje të ndryshme:

- i. pranë ambienteve të vëna në dispozicion nga SHISH;
- ii. pranë ambienteve të vëna në dispozicion nga MB;
- iii. në zyrat ku ushtron veprimtarinë Autoriteti, pranë Gardës së Republikës së Shqipërisë.

Në këtë kontekst janë marrë masat për ndarjen e përgjegjësisë për materialin arkivor kaluar në administrim të institucionit.

Kur institucioni të ushtrorë aktivitetin në godinën e caktuar sipas VKM-së nr. 935/2017, pjesë e Planit të Masave do të jetë dhe “Skema e Sigurisë Fizike të Godinës së re të Autoritetit”.

Me Urdhrin nr. 60, datë 01.11.2017 “Për krijimin e Komisionit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH” është krijuar Komisioni për Shqyrtimin e Informacionit të Klasifikuar, i cili shqyrton llojet e dokumentacionit që prodhon institucioni dhe propozon atë kategori dokumentesh që duhen klasifikuar, rivlerësuar, nivelin e klasifikimit dhe afatin e ruajtjes së këtij niveli. Komisioni është ngritur në mbështetje ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar, “sekret shtetëror”, të ndryshuar dhe të VKM-së nr. 123, datë 15.03.2001, “Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror, procedurat që përdoren për identifikimin e tij dhe të delegimit të autoritetit të klasifikimit”.

## Zhvillimi teknologjik

Në janar 2019, nga Ambasada Gjermane u dhurua infrastruktura digjitale për dëshmitë gojore, u instalua dhe konfigurua serveri Data Storage NAS, ku ruhen të gjitha materialet mbi dëshmitë gojore. Në vijimësi, për siguri më të lartë dhe akses të lehtësuar është kryer kalimi i të gjithë arkivit që disponon AIDSSH nga HDD i jashtëm në këtë server. Në mënyrë periodike është kryer mirëmbajtja dhe përditësimi i serverit Data Storage NAS, janë krijuar *active directory*, ku bëhet e mundur ruajtja e dokumentacionit të institucionit si dhe pajisja me *sharefolder* e çdo punonjësi. Pajisjet e nevojshme për të realizuar regjistrimin dhe ruajtjen e dëshmive janë testuar, instaluar dhe konfiguruar në ambientet e AIDSSH.

Në zbatim të kërkesave të lëna nga rezoluta e Kuvendit, Sektori i Zhvillimit Teknologjik, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arkivit dhe me konsulentin e pavarur, znj. Enkela Kuka, ka punuar për ndërtimin e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve (Case Management System). Ky sistem ka për qëllim të menaxhojë dhe automatizojë operacionet e AIDSSH, duke mbështetur çdo kërkesë drejtuar Autoritetit nga qytetarë, qeveria ose institucionet e pavarura, mediat, hulumtuesit etj. Janë rishikuar kriteret e specifikimet teknike të sistemit të menaxhimit të çështjeve dhe arkivit digjital që priten të realizohen në 2020-2021.

Në kuadër të detyrave që Rregullorja e Brendshme ka parashikuar për Sektorin e Zhvillimit Teknologjik është kryer pajisja e të gjithë punonjësve të rinj të AIDSSH me e-mail zyrtar në domain-in *autoritetidosjeve.gov.al*, konfigurimi i e-mail-it zyrtar në të gjithë kompjuterët e stafit, si dhe përditësimi i fjalëkalimeve sipas rregullores së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Është kryer mirëmbajtja e rrjetit të internetit, dhe pajisjeve përkatëse, duke ndërhyrë në raste problematikash apo të shtimit të stafit.

Me qëllim pasqyrimin e punës së AIDSSH në internet, në bashkëpunim dhe me mbikëqyrjen e DMSHEQ, është bërë

riorganizimi i faqes zyrtare të institucionit dhe secilës rubrikë, duke e përmirësuar, ristrukturuar dhe pasuruar me informacion. Po ashtu, është kryer mirëmbajtja e faqes zyrtare të institucionit [www.autoritetidosjeve.gov.al](http://www.autoritetidosjeve.gov.al), me publikime të reja, përditësime, përmirësime, etj. Në bashkëpunim me drejtoritë e institucionit, në faqe janë pasqyruar periodikisht informacione mbi aktivitetet e AIDSSH, njoftime për shtyp, konferenca shkencore, publikime për vende të lira pune, formularë për aplikime, materiale të përgatitura nga stafi, etj., me qëllim arritjen të një

---

<sup>1</sup> Numri total i përdoruesve që kanë vizituar faqen tone zyrtare gjatë vitit 2018 është **5439** ndërsa gjatë vitit 2019 është **6751**, nga të cilët numerohen 59 vizitues të rinj dhe 5380 vizitues ekzistues për vitin 2018, krahasuar me 6624 vizitues të rinj dhe 127 ekzistues për vitin 2019. Kohezgjatja mesatare e vizitës së një përdoruesi në faqe ka qenë **2 minuta e 15 sekonda** për vitin 2018 dhe **2 minuta e 3 sekonda** për vitin 2019. Grupmosha që mbizoteron është kryesisht 25-44 vjeç, por vihet re një përqindje më e lartë e grupmoshës 25-34 vjeç gjatë vitit 2018, përqindje e cila është më e shpërndarë gjatë vitit 2019.

Duke u bazuar në statistikat e faqeve me të klikuara, interesi përgjatë vitit 2018 ka qenë kryesisht në: 1. Aplikime – Akses për qytetaret (1260 klikime), 2. Kryetar (802 klikime), 3. Struktura (658 klikime), 4. Postimi “Ish-reparti 303 Spac-Mirdite” (360 klikime), 5. Anëtar – Simon Mirakaj (294 klikime), 6. Aplikime – Akses për agjencitë private dhe shtetërore (216 klikime), 7. Postimi “Fillon pluralizmi politik në Shqipëri, 12 Dhjetor 1990” (201 klikime), 8. Postimi “Ish-reparti riedukimit 311 Qafe Bari, Puke” (189 klikime), 9. Anëtar – Altin Hoxha (178 klikime), 10. Anëtar – Marenglen Kasmi (173 klikime).

Ndërsa interesi përgjatë vitit 2019 ka qenë në: 1. Aplikime – Akses për qytetaret (1340 klikime), 2. Postimi “Shqipëria u pranua në organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut Nato 4 Prill 2009” (529 klikime), 3. Postimi “Fillon pluralizmi politik në Shqipëri 12 dhjetor 1990” (345 klikime), 4. Postimi “Marreveshje mes AIDSSH dhe Qendres së bashkëpunimit nderfetar” (171 klikime), 5. Struktura (497 klikime), 6. Aplikime – Akses për agjencitë private dhe shtetërore (314 klikime), 7. Aplikime – Format i kërkesës për takim dhe ankese (215 klikime), 8. Postimi “Abstraktet fituese për

numër sa më i madh qytetarësh-përdorues të faqeve online për marrjen e informacionit të plotë e të besueshëm.

Interesi i qytetarëve për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në faqen zyrtare matet nga statistikat e vizitorëve të faqes, që mundësohen nga Google. Në këtë kuadër, janë hartuar raporte mujore dhe analiza bazuar në këto statistika, si të përgjithshme, po ashtu edhe të bazuara në shtete/qytete, grup mosha, gjini, gjuhë, rubrika të ndryshme të faqes, etj.<sup>1</sup>

konferencën ndërkombetare shkencore “Fytyra e ‘Armikut të popullit’ gjatë diktaturës së proletariatit në Shqipëri 1944-1990” (197 klikime), 9. Postimi “Communist concentration camps of the past haunt today's Albania” (196 klikime), 10. Postimi “Reagim i Autoritetit për akuzat mbi situatën e arkivave të ish-Sigurimit të Shtetit sot” (128 klikime)

Përsa i përket statistikave të bazuara në vendndodhje, në të dyja rastet numri më i madh i vizitorëve ka qenë nga Shqipëria, por përqindja e vizitorëve është më e lartë në vitin 2019 (81%) krahasuar me vitin 2018 (68%). Pjesa tjetër e klikimeve kanë ardhur nga përdorues që jetojnë jashtë Shqipërisë. Konkretisht, gjatë vitit 2018 interesi ka qenë nga vendet si Amerikë, Francë, Kosovë, Gjermani, Itali, Birtani e Madhe, Rusi, Hollande, Greqi. Nëse bëjmë një krahasim me vitin 2019, është rritur numri i vizitorëve nga Kosova e Italia dhe ka patur gjithashtu vizitues edhe nga Zvicra, Belgjika e Kanadaja.

Në lidhje me kanalet e përdorura për të mbërritur tek faqja jone, në të dy vitet ka mbizotëruar motori i kërkimit Google, i cili ka sjelle 3357 vizitues gjatë vitit 2018 dhe 4918 vizitues gjatë vitit 2019; duke vijuar me klikimet direkt në faqet, ku numri i vizitorëve ka qenë 1175 gjatë vitit 2018 dhe 1093 gjatë vitit 2019; shikueshmëria është rritur gjithashtu edhe nga rrjetet sociale (Facebook), nëpërmjet postimeve që janë publikuar (400 vizitues gjatë vitit 2018 dhe 799 vizitues gjatë vitit 2019); ndërsa një pjesë e përdoruesish na vijne nga faqe referuese ku gjatë vitit 2018 mbizotëroni Ekipedia dhe gjatë vitit 2019 janë me shumë të tilla, si evenëallshaveears.org, Ekipedia, ResPublica.al, dosjet.gov.al. Mund të themi që është rritur shikueshmëria që na vjen nga rrjetet sociale, si pasoje e përdorimit

Përveç pjesës teknike dhe problematikave që lidhen me infrastrukturën e institucionit, është punuar për zbatimin e projekteve të institucionit, si: lidhja me AKSHI-n dhe mirëmbajtja e platformës [dosjet.gov.al](https://dosjet.gov.al/), rezultat i projektit “Për studimin e rolit të shkencës në zhvillimin e shoqërisë gjatë viteve të para të vendosjes së regjimit komunist (1945-1954)” me PERFORM.

Mirëmbajtja e faqes “**Edhe muret kanë veshë**” të dëshmime gojore, në shqip dhe anglisht. Është mbështetur me pajisje regjistrimi i dëshmime gojore dhe ruajtja e tyre, në pajisjet përkatëse të dhuruara nga Ambasada Gjermane, të konfiguruar në ambientet e institucionit. Të dy platformat janë lidhur me faqen zyrtare të Autoritetit. Gjatë këtij viti është krijuar **Vlog/ YouTube Channel** për AIDSSH, ku janë publikuar video të aktiviteteve të organizuara, rubrika nga mediat, dokumentarë, etj. Blogu mirëmbahet, pasurohet dhe përditësohet vazhdimisht, në bashkëpunim të ngushtë me DMSHEQ.

Për konferencat shkencore është krijuar një faqe ueb e dedikuar, me informacion të përmbledhur dhe të mirëorganizuar [konferencashkencore.ëordpress.com](https://konferencashkencore.ëordpress.com), me temat, pjesëmarrësit, fituesit, abstraktet, bio-t e studiuesve, galeri fotosh, publikime, media, etj. Po ashtu **Blogu “Muze Memorial Tepelenë”** <https://muzememorialtepelene.ëordpress.com>, ku janë publikuar të dhëna dhe materiale për Kampin e Tepelenës. Blogu mirëmbahet, pasurohet dhe përditësohet në varësi të të dhënave.

Platforma e publikimeve online **ISSUU** ka gjetur përdorim të gjerë përsa i përket paraqitjes online të të gjitha botimeve të AIDSSH. Është pasuruar profili i institucionit në platformë dhe vazhdon publikimi për çdo artikull të ri që botohet, me përshkrim të shkurtër rreth përmbajtjes. Të gjitha botimet e AIDSSH në gjuhën shqipe dhe angleze janë në

---

me te gjere te tyre gjate kohes dhe gjithashtu jane shtuar faqet referuese ku permendet Autoriteti e nepermjet linkut perdoruesit drejtohen direkt ne faqen tone. Ne nje krahasim te pergjithshem,

[www.issu/aidssh.com](http://www.issu/aidssh.com), e lidhur me faqen zyrtare për të lehtësuar aksesin në materialet e publikuara.



Në zbatim të Rregullores “*Mbi publikimet e veprimtarisë së Autoritetit në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj*” miratuar me Vendim të Autoritetit Nr. 88, datë 22.02.2019, ka vijuar puna për publikimin online në faqen zyrtare të AIDSSH të të gjitha vendimeve dhe aktiviteteve të institucionit. Në këtë mënyrë janë publikuar të gjitha vendimet e vitit 2019, të ndarë sipas muajve përkatës. Përveç kësaj, janë publikuar gjithashtu online në faqen zyrtare vendimet e KDZH-së për deklasifikimin e dokumenteve dhe të gjitha aktivitetet e AIDSSH.

### 6.1.5 Të dhëna dhe shifra mbi aktivitetin e AIDSSH-së të krahasuara me vitin 2017, 2018, 2019

#### Digjitalizimi dhe deklasifikimi i dokumenteve arkivore

Të dy proceset, digjitalizimi dhe deklasifikimi i dokumenteve gjatë vitit 2018 kanë rezultuar me rritje të konsiderueshme të numrit të dokumenteve të digjitalizuara dhe dokumenteve të deklasifikuara. Grafiku më poshtë tregon të dhënat krahasuese, të realizuara për të dy proceset gjatë vitit 2017, 2018 dhe 2019.


raporti i shifrave dhe shikueshmerise pergjate 2019 eshte me i larte dhe ka ardhur ne rritje.







*Figura: Paraqitja në formë grafike e dokumenteve të digjitalizuara dhe të deklasifikuara gjatë tre viteve të fundit*

***Kërkesa individuale dhe institucionale të paraqitura pranë AIDSSH-së gjatë vitit 2019:***

- Gjithsej 674 kërkesa;
- Janë mbyllur procedurat për 696 kërkesa nga të cilat:
  - Me dokumentacion arkivor janë 248 kërkesa,
  - Pa dokumentacion arkivor janë 261 kërkesa;
- Janë përpunuar 69 413 faqe dokumentacion arkivor nga të cilat:
  - Janë anonimizuar 24 536 faqe dokumentacion arkivor i digjitalizuar;
- Janë përgatitur gjithë materialet e nevojshme dhe marrë pjesë aktive në 52 mbledhje të AIDSSH;
- Janë përgatitur 699 vendime (509 individuale + 190 institucionale)





## 5.2 Objektivat e institucionit për vitin 2020

Objektivat kryesorë të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2020 mbështeten në Planin Strategjik 2017-2020 dhe grupohen në disa kategori kryesore:

1. **Objektiva që kanë të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjen e kapaciteteve administrative**
  - Përfundimi i rikonstruksionit të godinës sipas projektit të hartuar nga Instituti i Ndërtimit, dhe pajisja e tij me rafte dhe facilitete të tjera, të domosdoshme për arkivin;
  - Rritja e bashkëpunimit me të gjitha institucionet partnere vendase e të huaja, si dhe vendosja e kontakteve me partnerë të rinj, në funksion të përmirësimit të infrastrukturës dhe rritjes së kapaciteteve administrative.
2. **Objektiva që kanë të bëjnë me themelimin e Autoritetit si burim arkivor qendror për kërkime mbi aktivitetet e Sigurimit**
  - Përfundimi i procesit të marrjes në dorëzim të të gjithë dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit nga institucionet arkivore në vend;
  - Hartimi i planit të transferimit të dokumenteve arkivore në godinën e re dhe transferimi i tyre në godinën e re sipas planit të miratuar;
  - Krijimi i sistemit të arkivit digjital, për lehtësim të procesit të kërkimit dhe konsultimit me dokumentet arkivore.
3. **Objektiva që kanë të bëjnë me sigurimin e së drejtës për informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**

Rishikimi dhe përmirësimi i procedurave të

  - brendshme për trajtimin e kërkesave individuale, institucionale dhe studimore;

Përmbyllja brenda afateve, për aq sa është e mundur,

  - e të gjitha kërkesave për informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të paraqitura pranë AIDSSH-së.
4. **Objektiva që kanë të bëjnë me nxitjen e kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar**

Organizimi i veprimtarive hulumtuese dhe

  - ndërvepruese, sipas planit të miratuar dhe kalendarit të kujtesës;

Zbatimi i strategjisë së komunikimit në vend dhe

  - jashtë tij, me grupet e synuara, dhe bashkëpunëtorët për zbardhjen e së shkuarës;

Finalizimi i suksesshëm i projekteve të nisura gjatë

  - vitit 2019, sipas parimeve të Rrjetit Europian të Kujtesës dhe Solidaritetit, ENRS.
5. **Objektiva që kanë të bëjnë me promovimin e transparencës dhe drejtësisë tranzicionale**
  - Mbështetja e punës për dokumentimin e krimeve të komunizmit, përfshirë kontributi në bërjen e drejtësisë; publikimi dhe shpërndarja e vendimeve dhe hulumtimeve shkencore
  - Bashkëpunimi me institucionet, organizatat kombëtare e ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë në proceset e drejtësisë tranzicionale.

## 6. Objektivat që kanë të bëjnë me menaxhimin

- Plotësimi i strukturës së Autoritetit, funksionimi si një trupë profesionale;
- Përmirësimi i rezultateve përmes krijimit të kushteve të përshtatshme të punës dhe studimit;
- Përdorimi i aseteve për ndërtimin e partneriteteve dhe burimeve.

## 7. Objektivat që kanë të bëjnë me zgjerimin e veprimtarisë së AIDSSH-së, duke bërë amendime, shtesa dhe përmirësime në ligj.

- Përshtatja e modeleve të institucioneve homologe të vendeve ish-komuniste, veprimtarisë së AIDSSH-së;
- Paraqitja e nevojave për ndryshime, shtesa, amendime të ligjit funksional pranë strukturave ligjvënëse;
- Zgjerimi i fushës së veprimit të AIDSSH në funksion dhe me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit dhe edukimin qytetar.

## 5.3 Synimet për të ardhmen

AIDSSH udhëhiqet nga misioni ligjor për dhënien e informacionit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për të edukuar shoqërinë dhe mbështetur vlerat demokratike të drejtësisë, të vërtetës, pajtimit dhe përgjegjësisë për brezat e ardhshëm.

Vizioni i Autoritetit është të sigurojë një platformë të besueshme nga e cila aksesohet trashëgimia dokumentare e ish-Sigurimit të Shtetit; t'i përfshijë qytetarët shqiptarë brenda e jashtë vendit në mundësinë për të kërkuar të dhëna,

informacion dhe kontekst nga arkivat e Sigurimit mbi përvojën e shtypjes komuniste; të shërbejë si burim i arritshëm institucional për të vlerësuar përvojën shqiptare në komunizëm, në mënyrë që ajo të mos përsëritet në të ardhmen.

Duke dhënë informacion mbi veprimtarinë e Sigurimit, Autoriteti synon të rrisë ndërgjegjësimin e publikut për regjimin komunist, që të ndihmojë në parandalimin e jotolerancës, ekstremizmit, lëvizjeve antidemokratike dhe përsëritjen e totalitarizmit; të inkurajojë një diskutim të hapur për të kaluarën komuniste dhe pasojat e saj, bazuar në transparencë, integritet, bashkëpunim me individë dhe institucione, po ashtu të inkurajojë angazhimin publik, duke mbështetur vlerat demokratike të drejtësisë, të vërtetës dhe pajtimit.

Dokumenti i Strategjisë për vitet 2017-2020 shërben si dokument udhëzues për veprimtarinë e Autoritetit dhe ka për qëllim të drejtojë dhe përqendrojë aktivitetet e tij, duke mundësuar edhe rishikime periodike të qëllimeve dhe objektivave.

Synimet për të ardhmen bazohen në vizionin e institucionit, realizimin e misionit të tij dhe përmbushjen e objektivave strategjike të përmendur më sipër.

## 5.4 Parashikimi trevjeçar në lidhje me vizionin e institucionit

Vizioni i AIDSSH-së në trevjeçarën e ardhshëm konsiston në:

- Përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues të funksionimit;
- Plotësimin e strukturë/organikës së AIDSSH-së;
- Ngritjen e infrastrukturës ligjore dhe logjistike për procesin e transferimit të dokumentacionit të

- disponueshëm nga AIDSSH, nga vendruajtjet aktuale në ndërtesën e re të Autoritetit;
- Deklasifikimin në total të dosjeve, duke përjashtuar ato që cenojnë sigurinë kombëtare;
  - Indeksimin digjital të dokumentacionit të administruar;
  - Përfshirjen e çështjes së të zhdukurve në fushën e veprimit të institucionit, përmes akteve ligjore përkatëse;
  - Zhvillimin e procedurave ligjore për trajtimin dhe përmbylljen e 1000 kërkesave në vit;
  - Shkurtimin e afateve kohore të shërbimit të dokumentacionit, në funksion të përgjigjes së kërkesave të paraqitura nga subjektet e interesuara;
- Realizimin e konferencave shkencore, dialogëve lokalë, ekspozitave dokumentare e të profileve njerëzore;
  - Ridimensionimin e figurave dhe personaliteteve, bazuar në kërkimin shkencor dhe bashkëpunimin me partnerë.
  - Platforma funksionale e ndërvepruese që qarkullojnë informacionin mbi veprimtaritë e AIDSSH, të përshtatura për të gjitha grupet e synuara, në shqip dhe anglisht.



# 06

DETYRIMET LIGJORE NGA  
AIDSSH DHE PËRGJEGJËSITË NË  
RASTET KUR LIGJI ËSHTË  
SHKELUR APO NUK ËSHTË  
KONSIDERUAR

Në komunikim aktiv me publikun dhe të interesuarit për realizimin e detyrave funksionale, AIDSSH është udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, mbrojtjes së të dhënave personale, dhënies së informacionit publikut, institucioneve dhe medias në kohë dhe me cilësi. Në përmbushje të detyrimeve ligjore,

nuk ka pasur raste të tejkalimit apo keqpërdorimit të kompetencave në ushtrimin e funksioneve për të cilat ligji nr. 45/2015 dhe Rregullorja e Brendshme e AIDSSH e ngarkojnë.

# 07

STATUSI NË ZBATIM TË  
REKOMANDIMEVE QË INSTITUCIONE  
TË TJERA KUSHTETUESE OSE TË  
PAVARURA KANË DHËNË PËR  
AIDSSH-në

Gjatë vitit 2019 u zhvilluan zgjedhjet lokale për pushtetin vendor. Në përputhje me VKM nr.283, datë 10.5.2019, *“Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore për vitin 2019”*; dhe veçanërisht në shpjegimet, udhëzimet dhe rekomandimet e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), u hartuan, miratuan dhe u ndoqën të gjitha procedurat, dokumentacioni dhe raportimet përkatëse në lidhje me monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore për vitin 2019.

Duke u bazuar në ligjin nr.9887, datë 10.08.2008, *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar, urdhrat, udhëzimet dhe vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen e të

Dhënave Personale, Autoriteti në procedurën e ndjekur *“Mbi publikimin e veprimtarisë së Autoritetit në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj”*, e materializuar kjo me vendimin nr. 88, datë 22.02.2019, mori në konsideratë mendime dhe sugjerime të dhëna nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave për miratimin e saj, e lidhur kjo me kryerjen e procesit të përpunimit të të dhënave personale dhe të kryerjes së procesit të anonimizimit të tyre, duke u bërë garant në mbrojtjen e të dhënave personale.

Në rastet e ankesave të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale apo në kuadër të së Drejtës për Informim, ku ka pasur ankime dhe janë iniciuar edhe procedurat për hetim administrativ të rasteve, Autoriteti ka rezultuar fitues, është dalë me vendim për zbatim korrekt të informimit nga AIDSSH dhe veprimtaria e koordinorit të caktuar për këtë qëllim ka qenë në përputhje me ligjin.

# 08

NDRYSHIMET NË KUADRIN  
RREGULLATOR PËR VITIN 2019 DHE  
EFEKTET E TYRE

1-Duke pasur parasysh bazën ligjore nga e cila Autoriteti udhëhiqet në punën e vet, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ligji nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ligji nr.9887, datë 10.08.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, ka dalë nevoja dhe është krijuar grupi i punës për hartimin e Rregullores mbi publikimet e veprimtarisë së Autoritetit, në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj. Mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu 1, “Parime të Përgjithshme”, Nenin 1, të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, parimet e përgjithshme të Programit të Transparencës së Autoritetit, për të bërë më të qartë e transparente vendimarrjen dhe veprimtarinë e tij, dhe rezultatet e tjera të prodhuara gjatë detyrave funksionale të ngarkuara me ligj, u vendos të hartoheshin një sërë rregullash të përmbledhura në rregulloren e publikimit të veprimtarisë së Autoritetit.

Sa më sipër, me Vendimin e Autoritetit nr. 88, datë 22.02.2019 është miratuar “Rregullorja mbi publikimet e veprimtarisë së Autoritetit në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj”, në të cilën parashikon kategoritë e dokumenteve që do të publikohen, mënyrën dhe formën si do të bëhet anonimizimi i të dhënave personale të tyre, mënyrën dhe afatet e publikimit, mundësinë e aksesit etj., konform bazës ligjore të sipërpërmendur, duke e bërë veprimtarinë e Autoritetit transparente dhe duke ndikuar fuqimisht në integritetin e institucionit.

2-Autoriteti e organizon punën e vet në zbatim të Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me Vendimin nr.21, datë 09.05.2017 të Autoritetit.

Pas një përvoje trevjeçare, doli e nevojshme të bëhet një shtesë në Rregullore, që ka të bëjë me afatet kohore të veprimeve procedurale dhe që ndihmojnë disa drejtori/sectorë të Autoritetit për të qenë korrektë me punën e tyre, e cila ka të bëjë me thelbin e punës në AIDSSH,

mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to të subjekteve të përcaktuara në këtë ligj. Duke përcaktuar veprime procedurale dhe afatet kohore të tyre, gjë e cila nuk parashikohet në ligjin specifik nr. 45/2015, ka mundësi më të mëdha për ta kryer detyrën e caktuar nga ligji me korrektësi dhe duke minimizuar korrigjimin e aktit.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 5, pika 7 të ligjit nr. 45/2015, me Vendimin e Autoritetit nr. 234, datë 24.04.2019, është miratuar “Për një shtesë në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit” me Vendimin nr. 21, datë 09/05/2017 të Autoritetit; ku përfshihen disa rregulla të hollësishme mbi afatet për përgjigje ndaj kërkesave për informim të subjekteve.

3-Në kuadër të detyrave që ligji nr.45/2015 i ngarkon Autoritetit, duke pasur parasysh organikën e institucionit, miratuar me Vendim të Kuvendit nr. 95/2016, dhe objektivat strategjikë në Planin Strategjik të Autoritetit (2017-2020) u hartua plani vjetor për vitin 2019 nga strukturat përgjegjëse të Sekretariatit Teknik, i cili pasi u diskutua, u miratua me Vendimin nr. 89, datë 22.02.2019 të Autoritetit.

Plani vjetor 2019 përcaktoi drejtimet kryesore të AIDSSH për përmbushjen e detyrave të parashikuara në ligjin nr. 45/2015, në VKM-në nr.98/2017 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e AIDSSH të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritetet e tjera publike”, në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që normojnë veprimtarinë e institucionit, si dhe në Planin Strategjik dhe atij të veprimit (2017-2020). Në përmbajtje të planit vjetor të çdo drejtorie/sectori u vendosën objektivat, aktivitetet që do të zhvillohen për të arritur objektivat, afati kohor, struktura

përgjegjëse që do të realizojë objektivat, si dhe dokument provues për arritjen e objektivave.

4. AIDSSH ka hartuar projekt VKM për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “kthimi në vend kujtese i vendëkzekutimit dhe vendvarrimit të viktimave të 26 shkurtit 1951”, i cili është përcjellë Bashkisë Tiranë për vijimin e mëtejshëm të procedurave.

5. Njëherazi është punuar lidhur me projekt propozimin deri në miratimin nga Këshilli i Ministrave i VKM-së Nr. 93, datë

27.02.2019, *“Për përcaktimin e tarifave dhe pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”*, detyrim ligjor ky që buron nga zbatimi me korrektësi i ligjit 45/2015.

Për gjatë vitit 2019 janë miratuar një sërë urdhrash të nxjerra nga titullari i institucionit, në aspektin organizativ dhe funksional, të cilat kryesisht normojnë dhe dispiunojnë veprimtarinë e Sekretariatit Teknik në AIDSSH, në bazë të ligjit organik dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

09

MBI PROBLEMATIKAT E NDESHURA  
NË VEPRIMTARINË E AIDSSH-SË ME  
QËLLIM GJETJEN E RRUGËVE MË  
EFIKASE PËR ZGJIDHJEN E TYRE  
NGA KUVENDI DHE KËSHILLI I  
MINISTRAVE



Veprimtaria e AIDSSH-së, në bazë të ligjit organik 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” dhe akteve të tjera ligjore që normojnë funksionimin e institucionit, siç edhe rezulton më sipër, është fokusuar në tre drejtime kryesore:

Së pari, aksesit i çdo qytetari në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit sipas ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit” dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Së dyti, vlerësimi i cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve/zyrtarëve përpara emërimit apo ngritjes në detyrë, kur kjo kërkohet nga institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, sipas një hierarkie të parashikuar në ligj, si dhe të gjithë të zgjedhurve nga populli, deputetë dhe të zgjedhur vendorë;

Së treti, krijimi i infrastrukturës së duhur për mundësimin e kërkimit shkencor dhe informimin e medias mbi veprimtarinë dhe historikun e ish-Sigurimit të Shtetit.

Në zbatim të ligjit nr. 45/2015 *“Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*, në vitin 2017, qeveria ka miratuar VKM nr. 98, datë 15.2.2017 *“Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritetet e tjera publike”*. Mbështetur në VKM-në e sipërcituar, AIDSSH ka nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ Shtetëror dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave. Shërbimi Informativ Shtetëror, sikurse është komunikuar më herët, mbështetur në ligjin 45/2015 dhe VKM nr. 98, datë 15.2.2017, ka përfunduar dorëzimin dhe kalimin nën administrim të AIDSSH-së të të gjithë dokumentacionin arkivor të përcaktuar në Nenin nr.1, të VKM nr. 98, datë 15.20.2017,

mjetet e kërkimit arkivor dhe kompjuterët me të dhënat përkatëse. Për sa i përket procesit të kalimit nën administrim dhe të marrjes në dorëzim të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit nga Arkiviti i Sistemit të Ministrisë së Brendshme tek AIDSSH, procesi ka ecur me ritme shumë të ngadalta duke tejkaluar çdo afat dhe për më tepër, që prej muajit maj 2019 është pothuajse i bllokuar.

Nga ana e AIDSSH-së, mbështetur në parashikimet e ligjit 45/2015, VKM 98/2018 dhe rezoluta e Kuvendit datë 13.5.2019, ka pasur komunikim të vazhdueshëm shkresor dhe takime dypalëshe me përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku janë diskutuar dhe shpjeguar në hollësi procesi dhe problematika dhe me gjithë vëmendjen e tyre për të kuptuar situatën e krijuar, deri më tani nuk është arritur zgjidhja e problemit. Kjo situatë ndikon drejtpërsëdrejti në veprimtarinë e AIDSSH dhe për më tepër, në shërbimin e ofruar qytetarëve dhe subjekteve të tjera të parashikuara me ligj.

Një tjetër vështirësi, sikurse u theksua më lart është mungesa e fondeve për përfundimin e rikonstruksionit dhe pajisja e godinës me mjetet e domosdoshme logjistike si, kompjuterë, tavolina, karrige, raftet, etj.

Për një kohë relativisht të gjatë në 2019, problem ka qenë deklasifikimi i shkresave të brendshme, që ka përbërë pengesë për vënien në dispozicion të akteve të përdorshme dhe do të bënte të mundur t’u shërbehen kërkuesve në kohë të shkurtër dhe në këtë kontekst, vendosja e një dispozite ligjore për deklasifikim tërësor të dokumentacionit që përfshihet në një nga katër nivelet e klasifikimit, duke përfshijtur ato dokumente që cenojnë sigurinë kombëtare, do të ishte zgjidhja e problemit.

Duke vlerësuar maksimalisht bashkëpunimin me Kuvendin e Shqipërisë dhe duke shpresuar në adresimin dhe zgjidhjen e problemeve, më poshtë pasqyrohen shqetësimet dhe nevojat prioritare, për mirëfunksionimin e institucionit.

Shprehim shqetësimin për buxhetin e cunguar për vitin 2019, edhe në Projektbuxhetin Afatmesëm 2019-2021, kryesisht në zërin Investime, krahasuar me kërkesat e herëpashershme

dhe të argumentuara me projekte konkrete. Për shkak të Urdhrit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për pezullimin e të gjitha procedurave të prokurimit, pavarësisht faktit se po finalizoheshin procedurat për lidhjen e kontratës me operatorin ekonomik, ky buxhet minimalist nuk u realizua. Është në të mirën e punës së funksionimit me përbërje të plotë të Anëtarësisë së Autoritetit, zhvillimi i procedurave të nisura nga Kuvendi për zëvendësimin e një prej anëtarëve të Autoritetit, i cili ka mëse dy vjet që ka dhënë dorëheqjen dhe ende nuk kanë përfunduar procedurat, fakt ky që e vështirëson vendimmarrjen kolegjiale të institucionit.

Mes sfidave të ardhshme mbetet plotësimi i strukturë/organikës së miratuar nga Kuvendi sipas Vendimit nr. 95/2016 të Kuvendit të Shqipërisë "Mbi miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit", aktualisht nga 60 punonjës që duhet të ishin, Qeveria ka mbështetur në ligjin e buxhetit vetëm 50% të strukturë/organikës së AIDSSH-së.

# 10

NEVOJA PËR NDRYSHIME NË  
KUADRIN LIGJOR QË RREGULLON  
VEPRIMTARINË E AIDSSH-SË

## **Ndryshime të mundshme në Ligjin 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”**

Nisur nga përvojat më të mira të institucioneve homologe në vendet e Evropës Lindore, si dhe adresimi dhe zgjidhja e problemeve të hasura gjatë zhvillimit dhe zbatimit të procedurave të parashikuara në ligjin 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” dhe së fundmi, ligji 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, Autoriteti shpreh nevojën **për disa shtesa dhe ndryshime ligjor prioritare** në Ligjin 45/2015, të cilat në tërësi rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni në zbatim të detyrave të ngarkuara nga ligji. Në veçanti, një ndryshim lidhet drejtpërsëdrejti me zbatimin e afatit kohor brenda 31 marsit 2020, për verifikimin e figurave të zyrtarëve përpara emërimit apo ngritjes në detyrë apo dhe të të zgjedhurve. Këto propozime kanë qenë pjesë e diskutimeve në disa mbledhje të Autoritetit, është debatuar lidhur me përmbajtjen e tyre dhe në vlerësim të shumicës së Anëtarëve të Autoritetit është parë e arsyeshme t’u dërgohen strukturave drejtuese të Kuvendit të Shqipërisë.

OSBE, si partner që ka dhënë asistencë teknike dhe juridike në nxjerrjen e ligjit 45/2015, njëherazi ka shprehur gatishmërinë në angazhimin e saj në përmirësimin e kuadrit ligjor të sipërcituar, jo vetëm për ndryshimet ligjore prioritare, por dhe për ndryshime të tjera ligjore, që lidhen kryesisht me të zhdukurit, si dhe me përcaktimin dhe procedurën që do ndiqet me vendet e kujtesës (muzetë, datat përkujtimore, dekorimet, medaljet, etj), për sa përfshihen në fushën e veprimit të ligjit 45/2015, por dhe në ligje të tjera organike në këtë fushë, në funksion të unifikimit dhe harmonizimit të këtij legjislativi.

Në këtë kontekst, lind nevoja për disa shtesa dhe ndryshime ligjore në ligjin 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për

Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, që do të krijojnë mundësinë për produkt më cilësor të institucionit e funksionimin normal të punës, për përmbushjen me sukses të misionit të AIDSSH-së.

Gjithashtu, po punohet për ndryshime në ligjin funksional, duke marrë për bazë dhe modelin polak, për të zgjeruar veprimtarinë e Autoritetit me aktivitete mbi memorien kolektive dhe çështjen e gjetjes së të zhdukurve në diktaturë.

Njëherazi është punuar edhe për disa ndryshime në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, futjen në skanerin e AIDSSH-së të të gjithë kandidatëve të pushtetit vendor që do të marrin pjesë në procesin zgjedhor, si në poste drejtuese, ashtu edhe për anëtarë të këshillave vendorë, si dhe për disa shtesa e ndryshime në ligjin 112/2013 “Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, në drejtim të verifikimit nga AIDSSH të pastërtisë së figurës së personit që propozohet për të marrë medalje, dekorata apo tituj nderi.

Në dy zgjedhjet e fundit elektorale, të zhvilluara përkatësisht në qershor 2017, zgjedhjet parlamentare dhe në qershor 2019, zgjedhjet vendore, partitë politike të regjistruara në zgjedhje dhe këtu kemi parasysh partitë e mëdha politike parlamentare, si PS dhe ato jashtë parlamentit, si PD dhe LSI etj, nuk kanë paraqitur kërkesë pranë AIDSSH, në lidhje me ekzistencën e informacioneve në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për kandidatët për deputetë apo kryetarë bashkie, në zbatim të ligjit 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” me te cilin ushtron veprimtarinë e vet ky Autoritet.

Në këtë kontekst dhe në kuadër të vlerësimit të figurës së pastërtisë të kandidatëve për deputetë apo kandidatëve për kryetarë bashkie, për qëllime të transparencës së figurës së tyre gjatë fushatave elektorale, sipas nenit 30 të ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, është e nevojshme ndërhyrja në dispozita

të veçanta të legjislacionit zgjedhor, duke bërë amendimet e duhura, amendime që u janë bërë prezente Bashkëkryetarëve të Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore. Amendimet e përgatitura dhe të përcjella zyrtarëve të lartë zgjedhorë synojnë besueshmëri dhe kandidatë me figurë të pastër morale në zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore, në funksion të transparencës së fushatës zgjedhore, ku gjatë fushatës elektorale, zgjedhësit të kenë mundësi të informohen për pastërtinë e figurës së kandidatit që do të votojë.

**Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.188 datë 04.03.2015, "Për miratimin e rregullores për sigurimin e personelit", si dhe në Pyetësorin e Sigurisë, në këndvështrimin ligjor të AIDSSH-së**

Duke krahasuar dispozita të veçanta të ligjit ligjit 45/2015, "Mbi të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" me dispozita të veçanta të Ligjit nr.8457, datë 11.02.1999, "Për

informacionin e klasifikuar", i ndryshuar, vërehet ngjashmëri mes tyre, kryesisht në parimet e përgjithshme dhe rregullat për administrimin e dokumentacionit të klasifikuar.

Sa më sipër, si dhe në bazë e për zbatim të ligjit 45/2015, "Mbi të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" me të cilin operon AIDSSH, jemi të mendimit se ekzistojnë kushtet e mundshme për përfshirjen e Autoritetit në këtë proces, nëse do të ndërhyhej në nene të veçanta të Vendimit nr.188, datë 04.03.2015, "Për miratimin e rregullores "Për sigurimin e personelit", apo te pyetësori i sigurisë. Në këtë kontekst, është përgatitur një draft për disa shtesa dhe ndryshime në VKM e sipërcituar, ku jemi konsultuar dhe me zyrtarë të lartë të DSIK-së, draft që i është përcjellë Këshillit të Ministrave.

Bashkëlidhur si Aneks më vete ndryshimet ligjore të kërkuara në ligjin 45/2015, "Mbi të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

# 11


ORGANIZIMI I BRENDSHËM I  
INSTITUCIONIT

## Struktura dhe organika e AIDSSH-së

Vendimi i Kuvendit Nr.95, datë 22.12.2016 për strukturën dhe organikën përcakton që Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit duhet të ketë një personel prej 60 punonjësish, ku 5 prej tyre janë Anëtarët e

Autoritetit, të zgjedhur dhe të emëruar nga Kuvendi me Vendimet përkatëse; Nr.79, Nr.80, Nr.81, Nr.82, Nr.83, datë 17.11.2016.

Struktura dhe organograma e AIDSSH është:



Në fillim të vitit 2019, AIDSSH kishte 30 punonjës nga 60 të tillë që duhet të ketë në përputhje me strukturën dhe organogramën e mësipërme të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Me gjithë kërkesat e vazhdueshme, të argumentuara dhe të mbështetura në nevojat reale për të përballuar ngarkesën në rritje dhe zgjerimin e aktivitetit të AIDSSH, pranë Kuvendit të Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për shtesë të fondit të pagave në buxhetin e vitit 2019, për të

rritur numrin e punonjësve, me ligjim nr.99/2018, datë 3.12.2018, *“Për Buxhetin e vitit 2019”*, AIDSSH-së nuk iu vu në dispozicion asnjë fond pagash shtesë për punonjës të rinj për vitin buxhetor 2019.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.16, datë 16.1.2019 *“Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2019 në njësitë e qeverisjes qendrore”*, AIDSSH-së iu dha e drejta të punësonte 9 punonjës me kontratë të përkohshme, me kohë pune 6 ore/ditë, me afat punësimi deri në 31.12.2019.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.483, datë 10.7.2019 *“Për disa ndryshime ne Vendimin Nr.16, date 16.1.2019 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2019 në njësitë e qeverisjes”*, AIDSSH-së iu dha e drejta të punësonte edhe 4 punonjës shtesë me kontratë të përkohshme, me kohë pune 8 ore/ditë, me afat punësimi deri ne 31.12.2019.

Vetëm me aktin normativ të Këshillit të Ministrave nr.2, datë 3.10.2019 *“Për disa ndryshime në ligjin nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”*”, AIDSSH-së iu vu në dispozicion një shtesë e fondit të pagave për 10 punonjës të rinj.

### **Burimet njerëzore.**

Me hyrjen në fuqi të aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr.2, datë 3.10.2019 *“Për disa ndryshime në ligjin nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”*”, me Vendimin nr.638, datë 11.10.2019, Autoriteti miratoi planin e rekrutimeve për 10 punonjës shtesë për vitin 2019, përkatësisht:

- 1 punonjës në kategorinë e mesme drejtuese;
- 2 punonjës në kategorinë e ulët drejtuese;
- 7 punonjës në kategorinë ekzekutive

Bazuar në ligjin nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, Kodin e Punës, VKM-të përkatëse, praktikat dhe udhëzimet e Departamentit të Administratës Publike (DAP), që rregullojnë procesin dhe procedurat e rekrutimit, AIDSSH filloi procesin e rekrutimit të personelit që lejonte fondi i pagave shtesë, i miratuar me aktin normativ të sipërpërmendur.

Për shkak të kohës të shkurtër nga momenti i hyrjes në fuqi të aktit normativ deri në përfundim të vitit buxhetor, si dhe të kohëzgjatjes së detyrueshme të procedurave përkatëse të rekrutimit, u bë e mundur që brenda vitit 2019 të hapen dhe të mbyllen me sukses, me shpalljen dhe emërimet përkatëse të fituesve, procedurat e rekrutimit përkatësisht për:


- 1 punonjës në kategorinë e ulët drejtuese;
- 6 punonjës në kategorinë ekzekutive.

Gjatë vitit 2019 u zhvilluan dhe përfunduan me sukses edhe procedurat e rekrutimit të 13 punonjësve me kontratë të përkohshme në zbatim të Vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.16, datë 16.1.2019 *“Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2019 në njësitë e qeverisjes qendrore”*, si dhe nr.483, datë 10.7.2019 *“Për disa ndryshime ne Vendimin Nr.16, date 16.1.2019 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2019 në njësitë e qeverisjes”.*”

Gjatë vitit 2019, gjithashtu janë zhvilluar procedurat e rekrutimit për të plotësuar pozicione ekzistuese, të mbuluara me fond pagash, nga të cilat punonjësit, për arsye të konkurimit për një pozicion tjetër të shpallur në planin e rekrutimeve për vitin 2019, kanë lëvizur brenda AIDSSH-së, ose për arsye të ndryshme janë larguar, kanë ndërprerë marrëdhëniet me AIDSSH-në.



### Kapaciteti aktual i personelit të njësive



Në përfundim të procedurave të rekrutimit për vitin 2019, duke marrë parasysh pozicionet e plotësuara gjatë viteve 2016, 2017, 2018, 2019; numrin dhe pozicionet e personelit që aktualisht janë të mbuluara me fond pagash dhe janë të plotësuara; numrin dhe pozicionet të cilat janë të mbuluara me fond pagash e për momentin janë vakante, edhe pse janë shpallur procedurat e konkurrimit; shkalla reale e plotësimit të njësive me punonjës të AIDSSH, në fund të vitit 2019, krahasuar me numrin e punonjësve sipas strukturës dhe organikës, të aprovuar me Vendimin e Kuvendit nr.95/2016, jepet në tabelën e mëposhtme:

Njësia sipas Organogramës	Autoriteti/ Drejtoria	Sektori	Pozicioni	Sipas Organikës		Nr. Punonjësve me fond page		Nr. punonjësve të rekrutuar	% reale e rekrutimeve sipas organikës	
Autoriteti	Autoriteti		Anëtar	5	5	5		4	80%	
	Sekretaria e Kryetares		Sekretare	1	1	1		0		
Sekretariati Teknik	Sekretariati Teknik		Sekretar i Përgjithshëm	1	1	1		1	100%	
	Drejtoria e Informacionit	Sektori i kërkesave Individuale për informim	Drejtor	16	1	1	1		1	50.0%
			Përgjegjës		1	1	1		1	
			Specialist		9	3	3		3	
			Përgjegjës		1	1	1		1	
			Specialist		2	1	1		1	
	Drejtoria e Arkivit	Sektori i kërkesave Institucionale për informim	Specialist	10	2	1	1		1	80.0%
			Specialist		2	1	1		1	
			Drejtor		1	1	1		1	
			Përgjegjës		1	1	1		1	
			Specialist		2	2	2		2	
			Përgjegjës		1	1	1		1	
	Drejtoria e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar	Sektori i Ruajtjes së Fondeve	Përgjegjës	6	2	2	2		2	33.3%
			Specialist		1	1	1		1	
			Përgjegjës		2	0	0		0	
			Specialist		2	1	1		1	
	Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financave	Sektori i Përpunimit	Përgjegjës	15	1	1	1		1	46.7%
			Specialist		1	1	1		1	
			Përgjegjës		2	1	1		1	
			Specialist		1	1	1		1	
			Përgjegjës		1	0	0		0	
			Specialist		3	2	2		2	
			Përgjegjës		1	1	0		0	
			Magaziniere		1	0	0		0	
			Shofer		1	1	1		1	
			Sanitare		2	0	0		0	
			Drejtor		1	1	0		0	
	Drejtoria e Sigurisë dhe Zhvillimit Teknologjik	Sektori i Digjitalizimit	Përgjegjës	6	1	1	1		1	50.0%
			Specialist		1	1	1		1	
			Specialist		2	1	1		1	
			Specialist		2	1	1		1	
					60	60	60	40	33	55.0%

Sikurse shihet në tabelë, AIDSSH, pothuajse gjatë gjithë vitit 2019 ka punuar me gjysmën e kapacitetit të burimeve njerëzore të përcaktuara në Vendimin e Kuvendit Nr.95, datë 22.12.2016. Mungesa e burimeve njerëzore të mjaftueshme, në kuadër edhe të rritjes dita-ditës të aktivitetit dhe ngarkesës së punës të AIDSSH-së, ka sjellë vështirësi gjithmonë e më të mëdha e veçanërisht vonesa në kryerjen në kohë të misionit të AIDSSH-së për informimin e publikut dhe institucioneve.

Është pajisur personeli me certifikatat e sigurisë të nivelit përkatës, në përputhje me kërkesat e pozicioneve të punës. Janë kryer dhe kanë përfunduar me sukses (vërtetuar me certifikatat përkatëse) pranë Drejtorisë të Sigurimit të

Infomacionit të Klasifikuar (DSIK) trajnimet e nevojshme të lidhura me specifikën e punës së AIDSSH-së me informacionin e klasifikuar.

Gjatë vitit 2019, mbështetur në planin e trajnimeve të hartuar dhe miratuar në fillim të vitit, në bashkëpunim me ASPA (Shkollën Shqiptare të Administratës Publike), DPA, ILDKPI janë kryer një sërë trajnimesh për rritjen e njohurive dhe kapaciteteve të punonjësve të AIDSSH-së sipas fushave përkatëse. Konkretisht, lloji i trajnimeve dhe numri i punonjësve që kanë marrë pjesë në to jepet në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Numri i Temave	Tema e trajnimit	Numri i punonjësve	Institucioni Trajnues
1	Aspektet e Sigurisë së informacionit të klasifikuar	2	DSIK
2	Barazia gjinore dhe buxhetimi i përgjegjshëm gjinor	1	ASPA
3	Investimet Publike	3	ASPA
4	Mbi planin e trajnimeve për Sistemin Informatik të Menaxhimit Financiar , moduli BPPM	1	Ministria e Financave
5	Mbi planin e trajnimeve për Sistemin Informatik të Menaxhimit Financiar , moduli PBA	2	Ministria e Financave
6	Prokurimi publik, niveli bazë	2	ASPA
7	Prokurimi publik, niveli mesatar	1	ASPA
8	Kontrolli i brendshëm financiar dhe auditi	2	ASPA
9	Menaxhimi i Fondeve të BE	3	ASPA
10	Menaxhimi strategjik	1	ASPA
11	Planifikimi buxhetor dhe pasqyrat financiare	2	ASPA
12	E drejta për informim dhe mbrojtja e të dhënave personale	2	ASPA
13	Informimi mbi plotësimin e pyetsorit të vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit	5	Ministria e Financave
14	Kodi i Procedurës Administrative	6	ASPA
15	Njohuri bazë të statistikave zyrtare	2	ASPA
16	Roli i Autoriteteve Përgjegjëse në Sistemin e Elektronik të Deklarimit të Interesave publike	1	ILDKPI

17	Trajnim online, gjuhë e huaj, moduli "gjermanisht"	1	ASPA
18	Siguria kompjuterike, niveli bazë	5	ASPA
	Prezantimi me administratën publike		ASPA

### **Veprimtaria në kuadër të ndjekjes dhe zbatimit të ligjit për kontrollin e konfliktit të interesave, pjesë e Autoritetit Përgjegjës të AIDSSH.**

- Hartimi i raportit vjetor 2019 dhe dërgimi brenda afateve ligjore të Raportit në ILDKPKI, si dhe njoftimi dhe ndjekja e afateve ligjore për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratave të interesave private periodike vjetore, para fillimit në detyrë dhe pas largimit nga funksioni të subjekteve deklaruese të institucionit.
- Përgatitja dhe administrimi i gjithë dokumentacionit të nevojshëm në zbatim të Udhëzimit për Autoritetin Përgjegjës, me qëllim vënien në dispozicion institucionit kontrollues dhe monitorues të ILDKPKI.
- Ndjekja brenda të gjitha afateve ligjore dhe me të gjithë hapat e duhur, të konfliktit të interesit rast pas rasti të përgjegjëses së Sektorit të Ruajtjes së Fondeve të Drejtorisë së Arkivit, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore mbi të cilat funksionon ILDKPKI.
- Dorëzimi brenda afateve ligjore të deklaratave të interesave private periodike vjetore, të të gjithë subjekteve deklarues të AIDSSH.
- Për identifikimin dhe regjistrimin e rasteve të konfliktit të interesave nga Autoriteti Përgjegjës janë plotësuar autorizimet për parandalimin e konfliktit të interesave nga çdo zyrtar, të cilat janë administruar në dosjen përkatëse për 34 zyrtarë, nga të cilët 4 Kryetare/Anëtarë dhe 30 pjesë e stafit të Sekretariatit Teknik.
- Ndjekja dhe përfundimi brenda të gjitha afateve ligjore dhe me të gjithë hapat e duhur, të konfliktit të vazhdueshëm të interesit i cili u shfaq në rastin e

përgjegjëses së Sektorit të Ruajtjes së Fondeve të Drejtorisë së Arkivit, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore mbi të cilat funksionon ILDKPKI. Bazuar në dhënien e rekomandimeve për marrjen e masave për shmangjen e konfliktit të vazhdueshëm të interesit, rastit i është shkuar deri në fund, pasi rezultoi konflikt interesi i vazhdueshëm, dhe bëri të merreshin masa për shmangjen e tij.

### **Të ardhurat dhe shpenzimet, përfshi fondet e miratuara nga donatorët**

AIDSSH për zbatimin e buxhetit të vitit 2019, ka punuar në mbështetje të parimeve si::

Mbështetje në fondet buxhetore për realizimin e qëllimit kryesor të AIDSSH-së, informimin në bazë të kërkesave

- të individëve të prekur, të institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike dhe studiuesve e mediave.
- Mbështetje në fondet buxhetore për rritjen e performancës së personelit nëpërmjet trajnimeve të ndryshme.
- Mbështetje në fondet buxhetore për anëtarësimin në organizmat ndërkombëtarë dhe pjesëmarrjen në aktivitetet e organizuara prej tyre.
- Mbështetje me fonde buxhetore për transportin dhe mbledhjen e të gjitha dokumenteve dhe fondeve arkivore nga të gjithë arkivat e sistemit në të gjitha qarqet e vendit.
- Mbështetje në fondet buxhetore për të siguruar transparencë dhe besueshmëri nëpërmjet informatizimit të aktivitetit të institucionit dhe publikimeve periodike.

- Mbështetje në fondet buxhetore për mbarëvajtjen e punës në AIDSSH

Për vitin 2019, evidenca e realizimit të shpenzimeve të buxhetit për programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” krahasuar me planin vjetor me ndryshime, paraqitet si më poshtë:

***Në mijë lekë***

Nr	Emertimi	Buxheti Fillestar Viti 2019	Buxheti me ndryshimet Viti 2019	Realizimi faktik Viti 2019	
				Në vlerë	Në %
1	Planifikim-Menaxhim-Administrim	58 000	61 000	47 815	78 %

Përbërja e shpenzimeve buxhetore, sipas klasifikimit ekonomik të shpenzimeve, sipas buxhetit dhe realizimit faktik të vitit 2019, jepet në tabelën e mëposhtme:

***Në mijë lekë***

Llog	Emërtimi	Buxheti Fillestar Viti 2019	Buxheti me ndryshimet Viti 2019	Realizimi faktik Viti 2019	
				Në vlerë	Në %
600	Fondi i Pagave	32 500	35 500	33 533	94 %
601	Kontrib. Sig. Shoq & Shënd.	5 500	5 500	5 238	95 %
602	Mallra dhe shërbime të tjera	18 000	18 000	8 923	50 %
230	Kapitale të Patrëpëzuara	120	120	120	100 %
231	Kapitale të Trupëzuara	1 880	1 880	0	0 %
	<b>Totali</b>	<b>58 000</b>	<b>61 000</b>	<b>47 814</b>	<b>78 %</b>

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, për periudhën e raportuar, AIDSSH ka realizuar vlerën buxhetore sa më poshtë:

**Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore**, (zëri 600-601), është realizuar, në zbatim të strukturës organizative të miratuar, me Vendimin e Kuvendit nr. 95/2016, “Për

miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit”. Me ligjin nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019” ishte miratuar numri për 30 punonjës dhe me aktin normativ nr.2, datë 3.10.2019 numri i punonjësve u rrit me 10 vetë, si dhe fondi i pagave u shtua me një vlerë prej 3 milionë lekë.

Për vitin 2019, ishin miratuar edhe 13 punonjës me kontratë të përkohshme, të cilët janë paguar duke u trajtuar edhe me sigurime shoqërore.

Për sa më sipër, buxheti i pagave dhe i sigurimeve shoqërore është realizuar për numrin faktik të punonjësve respektivisht në vlerën **33 533 mijë lekë** për paga si dhe **5 238 mijë lekë** për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore, rreth **95%** e fondit të planifikuar vjetor.

Niveli prej 97% është nivel pozitiv për AIDSSH, pasi llogaritja e shpenzimeve për këtë zë dhe shtesa për fonde është bërë në mënyrë të saktë.

**Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime** (zëri 602 -606 ), për vitin 2019, është në vlerën 18 000 mijë lekë.

Sipas transaksioneve të kryera në Degën e Thesarit, ky zë shpenzimesh është realizuar në vlerën **8 923 mijë lekë** ose **50 %**, e planit total vjetor të shpenzimeve operative.

Ky fond është realizuar për:

1. Shlyerjen e detyrimeve për shërbimet postare, të internetit e telefonike.
2. Shpenzime për blerje furnizime të ndryshme si kancelari, materiale për pastrim, tonerë për funksionimin e pajisjeve kompjuterike, printerë dhe fotokopje, etj.
3. Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit.
4. Shpenzime në funksion të realizimit të qëllimit të Autoritetit, sigurimit të standardeve si libra dhe publikime profesionale.
5. Shpenzime të përkthimit, printimit dhe publikimit.
6. Shpenzime për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e Kryetares, Anëtarëve dhe personelit të Autoritetit në

aktivitete dhe takime pune të ndryshme brenda e jashtë Shqipërisë.

Niveli prej 50% është nivel jo i mirë për AIDSSH, pasi në planin vjetor të shpenzimeve ishte planifikuar një fond prej 6 milionë lekësh për marrjen e ambienteve me qira. Në muajin tetor, pas konfirmimit nga Garda e Republikës dhe detyrimit për të paguar energjinë elektrike dhe ujin, Grupi i Menaxhimit Strategjik u mblodh dhe vendosi që ky fond të përdorej për botimet e aktiviteteve dhe raporteve të Autoritetit, sipas kërkesës së ardhur nga Drejtoria e Mbështetjes Shkencore. U punua për specifikimet teknike dhe u hartua urdhër prokurimi për kryerjen e këtij shpenzimi. Nga ana e thesarit kjo praktikë nuk u pranua dhe për pasojë, shpenzimet operative nuk u realizuan për vitin 2019.

#### **Fondi për shpenzime kapitale (zëri 230-231)**

Nga monitorimi konstatohet se struktura e shpenzimeve kapitale sipas buxhetit fillestar është ndryshuar me shtimin e fondit për shpenzime kapitale të patrupëzuara në vlerën 2 000 mijë lekë.

#### **Fondi për shpenzime kapitale të trupëzuara (zëri 230-231)**

Në këtë zë shpenzimesh janë blerë 2 programe me kërkesë të sektorit të Zhvillimit Teknologjik në vlerën 120 mijë lekë.

Fondi prej 1 880 mijë lekë nuk u realizua për blerjen e pajisjeve kompjuterike dhe mobilje zyre, pasi u pezulluan të gjitha procedurat e prokurimeve pas urdhrimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Sektori i Financës, në kuadër të marrëveshjes ndërmjet AIDSSH-së dhe Ambasadës Suedeze ka realizuar hapjen e llogarive për të bërë të mundur transferimin e grantit dhe ka vazhduar me likuidimin e shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore të koordinatores së projektit.

# 12

KALLËZIMET PENALE DHE  
PROCESET GJYQËSORE

Për sa i takon kallëzimeve penale drejtuar Autoritetit gjatë vitit raportues 2019, rezulton se është ngritur vetëm një kallëzim penal, nga kallëzuesi Ll. K., i cili fillimisht është pushuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rikthyer nga Gjykata kompetente për plotësim të dokumentacionit. Ky proces nuk ka përfunduar ende.

Më poshtë renditen të detajuara çështjet gjyqësore të AIDSSH në proceset gjyqësore ku institucioni ka qenë palë në proces.

Nr.	Paditës	Faza e procesit	Komente
1	B. Sh.	Mbaruar procesi gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit.	Përfunduar procesi gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, Paditës B. Sh. dhe e paditur AIDSSH. Gjykata la në fuqi kërkesë padinë.
		Ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit	Përgatitur ankimi për çështjen gjyqësore me palë paditëse B. Sh. për në Gjykatën Administrative të Apelit, depozituar pranë Gjykatës. (ndjekja e çështjes për afatin e ankimit, pas shkresës së ardhur nga Avokatura e Shtetit, për ankimin në Apelin Administrativ. Takim me Kancelarin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, për çështjen në fjalë; takim me sekretaren e Gjykatës së Apelit Administrativ) Ankimimi për në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
2	P. P.	Përfunduar procesi gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.	Pas kalimit në gjykatën me kompetencë territoriale nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, në atë të Tiranës është ndjekur hapa pas hapi mbrojtja dhe pjesëmarrja në seancat gjyqësore dhe çështja ka përfunduar me rrëzimin e padisë, në favor të Autoritetit.  Pas ankimit të paditësit P. P. në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, është përgatitur dhe depozituar kundërankimimi nga ana e Sektorit Juridik të Autoritetit.
3	S. V.	Në proces gjykimi në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë	Çështja gjyqësore me kërkues S.V. me AIDSSH, që është thirrur në gjykim në cilësinë e Personit të tretë, plotësuar prapësimet dhe ndjekur çështjen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë; çështja ka përfunduar, pasi dhe me kërkesën dhe kërkuesit S. V., është përcjellë për gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.



		Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë	Përgatitur prapësimet dhe pjesëmarrje në seancë në çështjen gjyqësore me palë S. V. kundër AIDSSH. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, duke konstatuar moskompetencë e ka përcjellë çështjen në Gjykatën e Lartë, për të përcaktuar kompetencën ligjore.
4	S. N.	Në proces gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë	Përgatitur prapësimet, pjesëmarrje në seancën gjyqësore dhe përgatitje e konkluzioneve për çështjen gjyqësore me palë paditëse S. N. pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; ndjekur procesi seancë pas seance.... Faza e paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare dhe dhënia e vendimit nga ana e gjykatës. Prosesi ka përfunduar me rrëzimin e padisë së ngritur nga S. N. dhe në favor të AIDSSH.  S. N. ka apeluar vendimin në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
5	L. K.	Në proces gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë	Përgatitur prapësimet, pjesëmarrje në seancën gjyqësore për çështjen gjyqësore me palë paditëse L. K., pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë; përfaqësuesi në gjykim i L. K. nuk kërkoi shfuqizimin e Vendimit administrativ të Autoritetit, meqenëse çështja nuk kishte më karakter administrativ, gjyqtarja shpalli moskompetencë ligjore të Gjykatës Administrative dhe i përcolli aktet në Gjykatën Civile, pasi çështja merr karakter civil.
6	LI. K.	Në proces gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë	Përgatitur prapësimet, pjesëmarrje në seancën gjyqësore për çështjen me palë paditëse LI. K., pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë; janë ndjekur seancat dhe janë caktuar ekspertët për të vërtetuar pretendimet e paditësit. Pas përpjekjesh për paraqitjen e ekspertëve të caktuar nga Gjykata, në seancën e fundit u prezantuan aktet e ekspertimit, “vlerësim mjeko-ligjor” dhe “vlerësim psikologjik”. Gjykata la në fuqi kërkesë padinë.  AIDSSH e ka apeluar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.  Njëkohësisht, AIDSSH ka bërë ankimim ndaj vendimit të padrejtë të gjyqtarit G. H., pranë KLGJ dhe KPK.
7	G. Z.	Në proces gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë	Përgatitur prapësimet për Gjykatën Administrative të Rrethit Tiranë për çështjen administrative me palë: paditës G. Z. dhe i paditur AIDSSH, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së pjesshme të vendimit nr. 593 datë 04.10.2019 si dhe korrigjimin e vendimit nr. 333 datë 24.05.2019 marrë nga Autoriteti. Në muajin dhjetor është zhvilluar pranë Gjykatës

			Administrative seanca përgatitore, secila nga palët ka paraqitur pretendimet dhe prapësimet në mënyrë të përmbledhur. Nga ana e palës së paditur AIDSSH, është paraqitur kërkesa për thirrjen si palë e tretë në gjykim të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Kërkesa nuk është pranuar nga ana e Gjykatës. Seanca e radhës do të zhvillohet më 17 shkurt 2020.
8	Xh. Sh.	Proces gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë	<p>Përgatitje e deklaratës së mbrojtjes për procesin gjyqësor të çështjes civile me palë kërkuese Xh. Sh., person i tretë - AIDSSH, me objekt vërtetimi gjyqësor i faktit që Komisioni Shtetëror i ngritur në zbatim të Ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995, “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”, i ndryshuar, ka lëshuar për kërkuesin Xh. Sh. dëshminë e verifikimit nga ku vërtetohet se ky i fundit nuk është në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksioneve publike të përcaktuara në ligjin në fjalë për funksionin e Drejtorit të Policisë Kriminale, të mbajtur nga kërkuesi, për periudhën objekt verifikimi nga ana e Komisionit Shtetëror.</p> <p>Në datën 30.01.2020, u zhvillua seanca përgatitore pranë Gjykatës së Rrethit, ku secila nga palët paraqiti shpjegimet dhe prapësimet e veta. Nga ana e Gjykatës u la detyrë për palën kërkuese të provojë faktin e qenies si zyrtar i verifikuar nga ana e Komisionit.</p>